

# UDHËZIME

për Përfshirjen  
e Zvogëlimit të  
Rreziqeve nga  
Katastrofa në  
Nivel Lokal



British Embassy  
Skopje



Институт за демократија  
Социетас цивилис - Скопје



ukaid  
from the British people

# Impresum

**Titulli:**

Udhëzime për Përfshirjen e Zvogëlimit të Rreziqeve nga  
Katastrofa në Nivel Lokal

**Autor:**

mr. Vasko Popovski

**Botues:**

Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup

**Përkthyer nga:**

Vjosa Taipi

**Dizajni:**

Vlado Srbinoski

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

[idscs.org.mk](http://idscs.org.mk)

Ky publikim financohet nga UK aid nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Qëndrimet e përmendura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe politikat zyrtare të Qeverisë Britanike.



British Embassy  
Skopje



Институт за демократија  
Социетас цивилис - Скопје



# Rezyme

Duke pasur parasysh numrin në rritje të ngjarjeve katastrofike në territorin e vendit, pasojat e krizës pandemike të KOVID-19, si dhe rreziqet dhe kërcënimet e reja potenciale, theksohet nevoja e përfshirjes përkatëse në zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal. Qëllimi i këtyre udhëzimeve për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal është të vendosë bazat për integrimin e tyre në planifikimin strategjik dhe zhvillimor në nivel lokal, i cili do të mundësojë njësive të vetëqeverisjes lokale të arrijnë qëllimet e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit rezistent.

Ky dokument ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa dhe lidhjes dhe ndikimit mbi zhvillimin lokal, lidhjen midis katastrofave dhe zhvillimit, nevojës për përfshirjen, mundësive dhe mënyrat për integrimin e tyre. Përcaktimi i udhëzimeve specifike dhe lista teknike për integrimin praktik, të cilat do të mbështesin dhe lehtësojnë procesin e integrimin në nivel lokal. Kjo do të mundësojë njësive të vetëqeverisjes lokale të arrijnë më lehtë dhe me efikasitet objektivat e tyre strategjike dhe zhvillimore, duke kontribuar në zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se këto udhëzime janë të parat e llojit të tyre që përfshijnë zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal në rajonin më të gjerë dhe hapin rrugën për një planifikim më të mirë, më efikas dhe efektiv lokal strategjik dhe zhvillimor që do të jetë të harmonizuara me rreziqet dhe kërcënimet ekzistuese, kërcënimet e reja, gjatë kësaj do të parandalohen pasojat e rreziqeve ekzistuese dhe do të zbuten pasojat nga rreziqet e reja dhe të pa parashikuara, duke u kujdesur që të gjithë qytetarët në zonën e njësive të vetëqeverisjes lokale të jenë të përfshirë në proceset e menaxhimit me rrezikun nga katastrofa.

Me qëllim të zbatimit praktik të udhëzimeve, janë përgatitur tre lista teknike për të kontrolluar përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve në nivel lokal: Lista teknike për përfshirjen e zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në dokumentet e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit në nivel lokal, Lista teknike për të kontrolluar përfshirjen e zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projektit për zhvillim lokal dhe Listën teknike për vlerësimin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal.

# Shkurtesa

<b>ARM</b>	Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>BPV</b>	Bruto Prodhimi Vendor
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>SIGj</b>	Sistemi gjeo informativ
<b>GV</b>	Grupi i vlerësimit
<b>QRKMK</b>	Qendra Rajonale Kryesore për Menaxhim me Kriza
<b>SHQ</b>	Shtabi qendror
<b>DMSH</b>	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
<b>LMK</b>	Ligji për menaxhim me kriza
<b>TIK</b>	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>ZRK</b>	Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofa
<b>OKB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>RMV</b>	Republika e Maqedonisë së Veriut
<b>QRMK</b>	Qendra Rajonale për Menaxhim me Kriza
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>PSO</b>	Procedura standarde operative
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetit
<b>SMK</b>	Sistemi për menaxhim me kriza
<b>NJTZ</b>	Njësitë territoriale të zjarrfikësve
<b>KD</b>	Komiteti drejtues
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

<b>UNESCO</b>	Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin
<b>MZRK</b>	Menaxhimi i zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa
<b>UNDRR</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofa
<b>QMK</b>	Qendra për Menaxhim me Kriza

# Përmbajtja

fq.

3

## REZYME

4

## SHKURTESA

8

### 1. HYRJE

9

1.1 Udhëzime për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

9

1.2 Nevoja për përfshirjen e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofa në nivel lokal

13

### 2. TË PËRGJITHSHME PËR PËRFSHIRJEN E ZVOGËLIMIT TË RREZIQEVE NGA KATASTROFA NË NIVEL LOKAL

14

2.1 Hyrje

15

2.2 Lidhja midis katastrofave dhe zhvillimit

22

2.3 Kuadri global dhe kombëtar për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në zhvillimin lokal

27

### 3. PËRFSHIRJA E ZVOGËLIMIT TË RREZIQEVE NGA KATASTROFA NË PLANIFIKIMIN STRATEGJIK NË NIVEL LOKAL

28

3.1 Hyrje

29

3.2 Udhëzime për miratimin e planeve strategjike për zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

35

3.3 Përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet e zhvillimit strategjik lokal

45	<u>Lista teknike për kontrollin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në dokumentet e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit në nivel lokal</u>
51	<u>Udhëzime për përfshirjen e zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet strategjike të zhvillimit në nivel lokal</u>
56	<u>3.5 Vlerësimi i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal</u>
57	<b><u>4. KONKLUZIONE</u></b>
58	<b><u>BIBLIOGRAFIA</u></b>
60	<u>5.SHTOJCA</u>

# 1. HYRJE



## 1.1 Udhëzime për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

Duke pasur parasysh numrin në rritje të ngjarjeve katastrofike në territorin e vendit, pasojat e krizës pandemike të KOVID-19, si dhe rreziqet dhe kërcënimet e reja potenciale, theksohet nevoja e përfshirjes përkatëse në zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal. Përfshirja e politikave duhet të bëhet në planet dhe politikat strategjike, si dhe përmes planeve dhe programeve sektoriale dhe projekteve zhvillimore. Prandaj, qëllimi kryesor i këtyre Udhëzimeve për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal është vendosja e bazave për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në segmentet e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit në nivel lokal. Ky dokument përbëhet nga një pasqyrë e nevojës dhe gjendjes së përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal, përkufizimin e udhëzimeve të përgjithshme për përfshirje, si dhe listat teknike përkatëse për aplikim praktik. Qëllimi kryesor i këtyre udhëzimeve është të ndihmojë njësitë e vetëqeverisjes lokale të rrisin qëndrueshmërinë, si dhe të kontribuojnë që proceset e planifikimit të jenë në përputhje me parimet moderne të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, të jenë përgjegjësi e të gjithë shoqërisë (ang. whole-of-society approach ) dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes (ang. whole-of-government ). Ata gjithashtu kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të Kornizës për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa të Sendai 2015-2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe rrezistent në nivel lokal.

## 1.2 Nevoja për përfshirjen e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofa në nivel lokal

Profili i rreziqeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut karakterizohet nga një sërë rreziqesh natyrore (përmytje, zjarre, tërmete, rrëshqitje dheu, stuhi, temperatura ekstreme, thatësira, etj.) dhe rreziqe të shkaktuara nga njeriu (incidente dhe aksidente tekniko-teknologjike). Rreziqet që vijnë nga klima (p.sh. përmytjet, zjarret në pyje, thatësira, stuhitë, etj.) janë më të zakonshmet, më intensivet dhe shkaktojnë pasojat më të mëdha mbi popullatën, infrastrukturën kritike në nivel kombëtar dhe lokal, zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të vendin dhe komuniteteve, natyrën dhe biodiversitetin. Nga ana tjetër, tërmetet kanë ndikimin më të madh në shtet dhe komunitet për sa i përket

**Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofa** synon të parandalojë rreziqet e reja dhe të reduktojë katastrofat ekzistuese dhe të menaxhojë rrezikun e mbetur, duke kontribuar kështu në forcimin e rezistencës dhe si pasojë arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Burimi: UNDRR

dëmeve dhe humbjeve të mundshme dhe efektit afatgjatë në zhvillimin social dhe ekonomik. Rreziqet dhe kërcënimet nuk janë të barabarta me territorin e vendit dhe ndryshojnë në varësi të llojit të rreziqeve, nivelit të ekspozimit dhe rrezikut, si dhe kapacitetit për ballafaqim të sistemit për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa dhe komunitetet. Në nivel rajonal,<sup>1</sup> ka disa dallime midis rajoneve individuale, por në përgjithësi ato ndjekin profilin e rrezikut të vendit dhe shpërndarjen rajonale të rreziqeve mbizotëruese dhe niveleve të rrezikut. Rreziqet, niveli i rrezikut dhe përfaqësimi sipas rajoneve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Rrjedhimisht, këto rreziqe janë pak a shumë të pranishme në zonat e njësisive të vetëqeverisjes lokale.

Figura 1 - Ekspozimi ndaj rreziqeve në rajonet planore (BE, 2018)<sup>2</sup>

Rrezik	Niveli i rrezikut	Rajoni (et)
Përmbytja e lumit	I lartë	Verior, jugor, juglindor, qendror
Përmbytje në një mjedis urban	I lartë	I gjithë vendi
Zjarre në pyll	I lartë	I gjithë vendi
Tërmet	I mesëm	I gjithë vendi
Mungesa e ujit	I mesëm	I gjithë vendi (në veri të mesëm, i ulët në rajone të tjera)
Temperatura ekstreme	I mesëm	I gjithë shteti (rrezik më i ulët në pjesën perëndimore të vendit)
Rrëshqitje dheu	I ulët	Perëndim dhe Juglindje
Përmbytjet në brigje	I ulët	I gjithë vendi

Në dy dekadat e fundit në vendin tonë kanë ndodhur 12 ngjarje katastrofike që kanë marrë 72 jetë, kanë prekur rreth 1.3 milionë banorë ndërsa dëmet nga vetëm tetë katastrofa kanë kushtuar më shumë se gjysmë miliardë dollarë amerikanë.<sup>3</sup>

Krahas këtyre ngjarjeve katastrofike, gjatë vitit ndodhin një sërë ngjarjesh të tjera më të vogla në përmasa dhe magnitudë, për shembull shira të rrëmbyeshëm, stuhi e shoqëruar me breshër, stuhi bore, periudha me temperatura të larta ose të ulëta, rrëshqitje dhe erozione e të tjera. Edhe pse këto ngjarje nuk janë në fokusin

1. Niveli rajonal bazohet në rajonet planore ekzistuese në vend

2. European Union Civil Protection. Peer Review – Report North Macedonia 2018. 2019. p.14. [online]. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/y4pxv23m>.

3. Popovski, Vasko. DRR Chapter for the 4th National Communication on Climate Change (Report). UNDP. 2021. f.5

- Shumica e viktimave (22) janë pasojë e përmbytjeve të rrëmbyeshme në gushtin e vitit 2016, në Shkup.
- Zjarret në pyje në korrik 2007 prekën rreth një milion banorë në gjysmën territorit të vendit.
- Përmbytjet e vitit 2015 kushtuan më shtrenjtë, afërsisht 245 milionë dollarë.

e interesit, ato vazhdimisht gërryejnë qëndrueshmërinë e komunave, komuniteteve dhe qytetarëve duke varfëruar burimet e tyre të kufizuara dhe duke thelluar rreziqet ekzistuese dhe duke krijuar dobësi të reja dhe pabarazi sociale. Nëse merren parasysh faktorë të tjerë rreziku, si rritja e urbanizimit, shkalla e

degradimit mjedisor dhe ndikimi negativ mbi ekosistemet, parashikimet për ndryshime klimatike (më pak reshje por më intensive, periudha më të gjata të temperaturave të larta të shoqëruara nga thatësira) pritet që numri i këtyre ngjarjeve të rrisin dhe prishin rëndë funksionimin normal të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe komuniteteve.

Nga ana tjetër, me rreziqet dhe kërcënimet e reja dhe atipike si pandemia e KOVID-19, kriza e migrantëve e vitit 2015, ndikimi në rritje i ndryshimeve klimatike, të cilat kalojnë nga lëkundje akute në stresa kronike, në afat më të gjatë shkaktojnë pasoja të cilat përhapen në të gjitha sferat e jetës ekonomike, sociale dhe të përditshme të qytetarëve në nivel lokal. Përmasat e këtyre pasojave më së miri pasqyrohen në faktin se në kontekstin maqedonas, pandemia KOVID-19 vetëm në 20 muajt e parë të shfaqjes së saj i kushtoi shtetit maqedonas afërsisht 3.7 miliardë dollarë.<sup>4</sup> Për sa i përket realizimit të kompetencave dhe obligimeve themelore të njësive të vetëqeverisjes lokale, pandemia la pasoja të mëdha<sup>5</sup> si në aspektin e financimit ashtu edhe në aspektin e ofrimit të shërbimeve bazë komunale.<sup>6</sup> Për shembull, ka pasur një rënie në zërin e të hyrave të buxheteve komunale dhe një rritje në zërin e shpenzimeve duke pasur parasysh nevojën për ballafaqim me krizën. Për sa i përket shërbimeve, në disa sektorë si ai komunal dhe shëndetësor ka pasur rritje të volumit të ofrimit të shërbimeve. Shërbime të tjera, si mbrojtja dhe shpëtimi, kanë qenë të vazhdueshme, ndërsa të tjera, si arsimi, kanë funksionuar në mënyrë hibride. Në disa sektorë, si zhvillimi ekonomik lokal, ka pasur ulje të volumit të projekteve të realizuara, si për shkak të pandemisë, ashtu edhe për shkak të prioriteteve për reagim ndaj krizës dhe rishpërndarje të fondeve. Gjithashtu, kultura, sporti dhe rekreacioni janë vënë në pritje për shkak të karakteristikave të pandemisë. Gjithashtu, pandemia la pasoja të mëdha në mirëqenien dhe jetesën e qytetarëve, përmes numrit të madh të vdekjeve dhe sëmundjeve<sup>7</sup> pasojave mbi shëndetin pas infektimit, duke përfshirë statusin psikologjik, rritjen e varfërisë dhe papunësisë dhe qasjen e kufizuar në shërbimet bazë.

4. Një vit në kthetrat e koronës", Deutsche Welle, 26.02.2021. Në dispozicion në: <https://p.dw.com/p/3pwzH>

5. Më shumë në: Popovski, V., Trenovski, B., Popovski, T. Municipal Crisis Management Response to COVID-19 Pandemics. Municipal Financing and Affected Services in the Republic of North Macedonia. UNDP. 2020. pp. 31-33

6. Shërbimet që burojnë nga kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale sipas nenit 22 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

7. Në periudhën 26.02.2020 deri më 08.02.2022 janë regjistruar gjithsej 278,872 të infektuar dhe 8,599 vdekje. <https://covid19.who.int/region/euro/country/mk>

Rrjedhimisht, njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk duhet të neglizhojnë rreziqet nga katastrofa dhe kriza dhe në këtë mënyrë të rrezikojnë zhvillimin e tyre afatgjatë social dhe ekonomik dhe mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve dhe komuniteteve. Nisur nga e gjithë kjo dhe në bazë të faktit se njësitë e vetëqeverisjes lokale janë subjektet e para që merren me krizat dhe katastrofat (ang. first responders), si dhe subjektet e para që parandalojnë fatkeqësitë dhe katastrofat e ardhshme (Eng. first preventers), në vitet e fundit është theksuar nevoja për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal. Në fakt edhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Eng. Sustainable Development Goals),<sup>8</sup> Korniza për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa nga Sendai 2015 - 2030 (Anglisht Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015 – 2030)<sup>9</sup> dhe Marrëveshja për klimën nga Parisi (ang. Paris Agreement)<sup>10</sup> theksojnë nevojën për integrimin e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në politikat dhe sektorët e zhvillimit në mënyrë që të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm dhe rrezistent.

8. Kombet e Bashkuara, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm <https://sdgs.un.org/goals>

9. Korniza për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa nga Sendai 2015 - 2030 <https://web.archive.org/web/20200831111511/https://www.undrr.org/publication/sendai-framework-disaster-risk-reduction-2015-2030>

10. Marrëveshja e Parisit për Klimën: [https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=XXVII-7-d&chapter=27&-clang=en](https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XXVII-7-d&chapter=27&-clang=en)

# 2. TË PËRGGJITHSHME PËR PËRFSHIRJEN E ZVOGËLIMIT TË RREZIQEVE NGA KATASTROFA NË NIVEL LOKAL

## 2.1 Hyrje

Për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, rezistent, të balancuar dhe harmonik të njësive të vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme që zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa të merret parasysh dhe të përfshihet në mënyrë përkatëse në parimet dhe praktikën bazë të zhvillimit. Në këtë kontekst, kur bëhet fjalë për marrëdhënien, lidhjen dhe integrimin ndërmjet rrezikut nga katastrofa dhe zhvillimit, përkufizimi terminologjik i të njëjtit është pikënisja.

- ▶ Në atë drejtim, me **katastrofa**<sup>11</sup> sipas terminologjisë së UNDRR kuptohet çrregullim serioz i funksionimit të një komuniteti ose shoqërie që përfshin humbje dhe ndikime të gjera njerëzore, materiale, ekonomike ose mjedisore që tejkalojnë aftësinë e komunitetit ose shoqërisë së prekur, të ballafaqohet me përdorimin e burimeve të saj.
- ▶ **Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofa**<sup>12</sup> paraqet koncept dhe praktika për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa nëpërmjet përpjekjeve sistematike për të analizuar dhe menaxhuar faktorët shkaktarë të katastrofave, duke përfshirë ekspozimin e zvogëluar ndaj rrezikut, zvogëlimin e cenueshmërisë së njerëzve dhe pronës, menaxhim inteligjent me tokën dhe mjedisin, dhe përgatitje e përmirësuar për ngjarje të pafavorshme.
- ▶ Nga ana tjetër **zhvillimi**<sup>13</sup> përfshin aspekte dhe terma të ndryshëm në përkufizimin e tij, nga sipërmarrjet socio-ekonomike në vende dhe territore deri te “përpjekjet shumëdimensionale për të arritur një cilësi më të lartë jetese për të gjithë njerëzit”. Zhvillimi ekonomik, zhvillimi social dhe mbrojtja e mjedisit janë komponentë të ndërvarur dhe reciprokisht përforcues të zhvillimit të qëndrueshëm.
- ▶ Në atë kontekst, **zhvillimi i qëndrueshëm**<sup>14</sup> përkufizohet si zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre. Ai bën thirrje për përpjekje të përbashkëta për të ndërtuar një të ardhme gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe rezistente për njerëzit dhe planetin. Për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, është thelbësore të harmonizohen tre bërthama: zhvillimi ekonomik, përfshirja sociale dhe mbrojtja e mjedisit. Këta elementë janë të ndërlidhur dhe janë thelbësorë për mirëqenien e individëve dhe shoqërisë.

11. Strategjia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa <https://www.unisdr.org/files/7817UNISDRTerminologyEnglish.pdf>

12. Ibid

13. Kombet e Bashkuara, <https://research.un.org/en/docs/dev>

14. Kombet e Bashkuara, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, <https://www.un.org/sustainabledevelopment/development-agenda/>

- › Dhe së fundi, **rezistenca**<sup>15</sup>, ne mund ta kuptojmë si aftësinë e një sistemi, komuniteti ose shoqërie në rrezik për të përballuar, absorbuar, përshtatur dhe rikuperuar nga efektet e rrezikut në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive, duke përfshirë ruajtjen dhe rivendosjen e strukturave dhe funksioneve të tij thelbësore.

**Tërmeti në Shkup më 26 korrik 1963.**

- 9 gradë sipas shkallës së Merkalievit, 200,000 qytetarë të prekur, 1070 viktima (470 burra, 430 gra dhe 170 fëmijë), 3,300 të lënduar. Dëmi prej 15% BPSH i ish-Jugosllavisë ose ndërmjet 3 dhe 5 miliardë dollarë. U shkatërruan 85% e pasurisë kombëtare të qytetit (infrastruktura, industria, fondi banesor, etj.)

## 2.2 Lidhja midis katastrofave dhe zhvillimit

Siç shihet nga pjesa hyrëse, shteti, komunitetet dhe qytetarët përballen me rreziqe dhe kërcënime të ndryshme në zhvillimin e tyre socio-ekonomik dhe ekzistencën. Ekspozimi ndaj rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, shkalla e cenueshmërisë, si dhe aftësia për zbutje, gatishmëria, reagimi dhe përballimi i katastrofave dhe krizave, në një farë mase përcakton shtrirjen e pasojave dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Fushat e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofa




Figura 2 - Aspekte të lidhjes midis katastrofave dhe zhvillimit (UNESCO, 2017)<sup>16</sup>

dhe zhvillimi përkatësisht katastrofat dhe zhvillimi janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura, mund të identifikohen tre aspektet e veçanta, por në të njëjtën kohë të ndërlidhura, si më poshtë:

15. Strategjia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë [https://www.unisdr.org/files/7817\\_UNIS-DRTerminologyEnglish.pdf](https://www.unisdr.org/files/7817_UNIS-DRTerminologyEnglish.pdf)

16. Komiteti Social dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin, UNESCAP. Mainstreaming Disaster Risk Reduction for Sustainable Development: A Guidebook for the Asia-Pacific. 2017. p.5 [Online] [https://www.unescap.org/sites/default/files/publication\\_WEBdrr02\\_Mainstreaming.pdf](https://www.unescap.org/sites/default/files/publication_WEBdrr02_Mainstreaming.pdf)

- › **Katastrofat gërryejnë përfitimet e zhvillimit** - Dëmet dhe humbjet totale të shkaktuara nga tërmeti në Shkup në korrik 1963, ndryshoi tektonikisht zhvillimin social-ekonomik të qytetit dhe të shtetit të atëhershëm. Pa ndihmën solidare nga jashtë, për të ndihmuar rimëkëmbjen dhe për të zbutur pasojat, qyteti do të mbetej prapa në zhvillimin e tij dhe do të duhej të arrinte nivelin e zhvillimit që nga dita e tërmetit për shumë dekada pas tërmetit. Një shembull tjetër është vërshimi i vazhdueshëm i qytetit të Radovishit nga reshjet e rrëmbyeshme dhe vërshimet e lumenjve Radovishka dhe Sushička, gjatë kësaj me vetëm katër ngjarje të vitit 2008, 2013, 2015 dhe 2018 është shkaktuar humbja e jetës së një personi dhe dëme në vlerë prej më shumë se 7.632 milionë euro.<sup>17</sup> Këto dëme ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës dhe në vend që fondet komunale të përdoren në mënyrë proaktive për parandalimin dhe zbutjen e katastrofave, ato do të përdoren në mënyrë reaktive për përballim dhe rikuperim. Nga ana tjetër, katastrofat me përmasat e tyre prekin sektorët individualë në nivel kombëtar dhe lokal, duke çuar në shkatërrimin ose dëmtimin e infrastrukturës dhe shërbimeve kritike, shkatërrimin ose dëmtimin e shtëpive dhe bizneseve, rritjen e varfërisë dhe papunësisë, ndërprerjen ose përkeqësimin e qasjes në shërbimet bazë dhe realizimin e të drejtave, si dhe pasojat makroekonomike dhe fiskale. Si rrjedhojë e gjithë kësaj, pasojat për ekonominë dhe zhvillimin janë të mëdha dhe rezultojnë me devijime nga parashikimet e planifikuara të zhvillimit, duke çuar në huamarrje të reja për riparim të pasojave dhe rikuperim.
- › **Mangësitë zhvillimore krijojnë katastrofa** - Secili komunitet ka dinamikën e tij të zhvillimit dhe politikat dhe praktikat e caktuara që zbatohen mund të rezultojnë në disa mangësi, të cilat në një situatë të caktuar mund të rezultojnë me katastrofa. Më shpesh janë stresi kronik dhe goditjet akute<sup>18</sup> të cilat dobësojnë strukturën e rezistencës dhe shterojnë burimet dhe kapacitetet lokale, duke ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm me pasoja të rënda për qytetarët, veçanërisht grupet më të rrezikuara (gra, të rinj, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara). Si shembull është dhënë matrica e Komunës së Velesit<sup>19</sup> sipas së cilës stresi kronik mund të identifikohet si ndryshime demografike, mungesa e burimeve financiare, infrastruktura kritike e vjetër dhe e rrënuar, cilësia e shërbimeve komunale, përfshirja e pamjaftueshme e ZRK-ve në dokumentet strategjike, programore dhe planifikuese në nivel lokal, mungesa e planifikimit të integruar, shkalla e larët e papunësisë, rritja e pabarazisë sociale, praktikat e këqija të ndërtimit, praktikat e këqija mjedisore, ndotja nga industritë e rrezikshme, ndryshimet klimatike dhe degradimi dhe ndotja e mjedisit. Goditjet akute mund të gjenden në rreziqet natyrore, rreziqet biologjike, defektet e infrastrukturës së komunikimit dhe energjisë ose incidentet dhe/ose fatkeqësitë

17. Komuna e Radovishit. Prezantimi i informacionit për katastrofat e kaluara. 2021.

18. Me Stres kronik nënkuptohen ngjarje që përsëriten dhe dobësojnë strukturën urbane të komunave dhe qyteteve në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa goditjet akute nënkuptojnë ngjarje që ndodhin papritur dhe çrregullojnë funksionimin e komunave dhe qyteteve.

19. Komuna e Velesit. Plani strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa i Komunës së Velesit 2021 - 2025. 2021. Faq.34 <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/10/veles.pdf>



tekniko-teknologjike. Lista e këtyre disavantazheve mund të plotësohet nga rritja e cenueshmërisë ndaj katastrofave të qytetarëve të varfër, ekspozimi më i madh ndaj rreziqeve në shtëpitë e tyre, p.sh. vendbanime informale dhe lagje substandarde, me material ndërtimor jo standard.

- › **Zhvillimi krijon rreziqe të reja nga katastrofa që bashkohen me shtresat ekzistuese të rrezikut** - Ky aspekt përfshin faktorët ekzistues të rrezikut si cenueshmëria, pasojat e ndryshimeve klimatike, shkalla e degradimit të mjedisit, mungesa e parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve, mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut për parandalimin e katastrofave, niveli i ulët i gatishmërisë, statusi socio-ekonomik, standard i ulët jetësor. Fatkeqësitë ndodhin kur një ose më shumë nga këta faktorë dhe procese rezultojnë me rritjen e nivelit të cenueshmërisë. Në fakt, me zvogëlimin e mungesave në zhvillim, vendet dhe komunitetet bëhen më rrezikante ndaj rrezikut të katastrofave dhe për këtë arsye, zhvillimi është kryesor për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa.<sup>20</sup>

Për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, rezistent, të balancuar dhe harmonik të njësive të vetëqeverisjes lokale, **është e nevojshme që zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa të merret parasysh dhe të përfshihet në mënyrë përkatëse në parimet dhe praktikën bazë të zhvillimit.** Ky proces i përfshirjes së katastrofave në zhvillim, daton në fund të shekullit të kaluar përmes proceseve të krijimit të mekanizmave globalë të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofa. **Termi përfshirje (mainstreaming)** ka për qëllim “të paraqesë në plan të parë një çështje të rëndësishme që nuk është përgjegjësi apo punë e një sektori të caktuar, por është shqetësim i përbashkët i të gjithë sektorëve ose është ajo që quhet puna e të gjithëve. Filozofia thelbësore e përfshirjes është përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve si një çështje kryesore horizontale të vendoset në plan të parë, duke u bërë një parim thelbësor i qeverisjes që përshkon të gjithë sektorët dhe në të gjitha nivelet. Përfshirja shkon përtej sektorit publik dhe përfshin sektorë të tjerë si sektorin privat, bota e korporatave, akademinë, mediat, shoqërinë civile dhe komunitetet.”<sup>21</sup> Nëse lidhen nocionet e përfshirjes dhe zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, mund të arrijmë të përcaktimi terminologjik përkatës. Kështu, **mepërfshirje të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planifikimin dhe politikën strategjike dhe zhvillimore lokale** nënkuptohet integrimi i tij përmes rishikimit ose miratimit të planeve dhe politikave të reja në sektorë për të reduktuar ose zbutur efektin e rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese, për të parashikuar të ardhmen dhe për të reduktuar ose zbutur kontributin e zhvillimit lokal në krijimin e rreziqeve nga katastrofa.

Për rrjedhojë, kjo kontribuon që njësitë e qeverisjes lokale të jenë në gjendje të formulojnë politikën përkatëse dhe të zbatojnë masa dhe aktivitete për zvogëlimin e rreziqeve. Gjithashtu, kjo do të mundësojë parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve

<sup>20</sup> Komiteti Social dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin, UNESCAP. Mainstreaming Disaster Risk Reduction for Sustainable Development: A Guidebook for the Asia-Pacific. 2017. p.6 [Online] [https://www.unescap.org/sites/default/files/publication\\_WEBdrr02\\_Mainstreaming.pdf](https://www.unescap.org/sites/default/files/publication_WEBdrr02_Mainstreaming.pdf)

<sup>21</sup> Ibid..

të ardhshme dhe të reja, potenciale, ndërtimin e kapaciteteve për përgatitje, reagim dhe rikuperim, sigurimin e mbështetjes dhe qëndrueshmërisë ndaj zhvillimit lokal, përmirësimin e zbatimit të planeve dhe programeve sektoriale, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kritike lokale të jetë më rezistente ndaj katastrofave. Gjithashtu, përmes përfshirjes më të madhe të qytetarëve, bizneseve, akademisë dhe OJQ-ve, askush nuk duhet të lihet vetëm (ang. leaving no one behind) në rast të katastrofave dhe krizave.

Në këtë kontekst, rëndësia e lokalizimit të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, UNDRR<sup>22</sup> e ka identifikuar atë nëpërmjet aspekteve të mëposhtme:

- › ndikimet e katastrofave ndihen më drejtpërdrejt dhe intensivisht në nivel lokal;
- › rreziqet zakonisht ndodhin në nivel lokal dhe shumë nga mjetet më efektive për reduktimin e ekspozimit ndaj rrezikut, për shembull rregulloret për përdorimin e tokës dhe zbatimi i rregullave për ndërtim, janë në nivel lokal;
- › niveli lokal është vendi ku përqendrohen funksionet thelbësore për menaxhim me mjedisin jetësor dhe menaxhimin rregullator, të cilat janë thelbësore për zvogëlimin efektiv të rreziqeve nga katastrofa;
- › në nivel lokal, qeveritë dhe komunitetet mund të angazhohen më së miri me njëra-tjetrën dhe të punojnë së bashku;
- › zvogëlimi lokal i rreziqeve nga katastrofa shkon paralelisht me promovimin e menaxhimit të zhvillimit lokal dhe menaxhimit lokal me mjedisin jetësor;
- › aktorët lokalë janë të parët që reagojnë në rast të katastrofave, kështu që reagimet dhe rregullimet mund të miratohen dhe zbatohen më shpejt dhe në pajtim me kontekstin specifik.

Rrjedhimisht, përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa bazohet në postulatet e mëposhtme:

- › zvogëlim gjithëpërfshirës i rreziqeve duhet të integrohet në politikat në nivel lokal,
- › vendimet që miratohen nga organet e qeverisjes lokale duhet të përfshijnë faktet dhe aspektet e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa,
- › programet dhe planet strategjike, zhvillimore dhe sektoriale duhet të integrojnë zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa,
- › në të gjitha fazat e përgatitjes së projekteve për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të ndryshme nga sektorë të ndryshëm në nivel lokal, është e nevojshme të identifikohen aspektet e rreziqeve nga katastrofa dhe të përcaktohen masat për zbutjen e tyre,

22. Strategjia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, UNISDR. Words into Action Guidelines. Implementation guide for local disaster risk reduction and resilience strategies. A companion for implementing the Sendai Framework Target E. 2018. pp.16. [Online] [https://www.uncclearn.org/wp-content/uploads/library/unisdr - 57399\\_drrresiliencepublicreview.pdf](https://www.uncclearn.org/wp-content/uploads/library/unisdr - 57399_drrresiliencepublicreview.pdf)

- › përveç monitorimit të rregullt dhe të vazhdueshëm të zbatimit të projektit, është e nevojshme të përgatitet një vlerësim i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa dhe të identifikohen dhe kodifikohen mësimet e nxjerra.

Prandaj është e nevojshme të planifikohet lidhja midis zhvillimit dhe fatkeqësive, por edhe të integrohen politikat, praktikat dhe masat për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në kompetencat dhe përgjegjësitë lokale. Prandaj, mund të identifikohet një grup parimesh<sup>23</sup> për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në rrjedhat dhe fushat kryesore të zhvillimit lokal:

- › **Zhvillimi i mekanizmave ligjorë dhe rregullator** të cilat nuk duhet të jenë të centralizuara përkatësisht të rregullohen me një akt strategjik ose ligjor, por duhet të integrohen në dokumente strategjike sektoriale dhe akte ligjore. Kjo do të sigurojë vazhdimësinë dhe integrimin e procesit, përkatësisht përfshirja të jetë që në fillim të rregullimit normativ dhe në të gjithë sektorët përkatës. Në këtë mënyrë do të hiqej qasja që shpeshherë aplikojnë institucionet, përfshirë edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, dhe të udhëhiqen vetëm nga tematika, dokumenti i tyre strategjik apo akti ligjor. Për rrjedhojë, procesi i përfshirjes do të jetë proaktiv dhe do të ndjekë dinamikën e nevojshme normative të zbatimit të normave. Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes lokale miratojnë lloje të ndryshme aktesh dhe ato mund të jenë bazë për përfshirjen apo zbatimin e masave dhe aktiviteteve për uljen e rreziqeve në nivel lokal në sektorë dhe fusha të ndryshme. Nga ana tjetër, është e nevojshme të ketë sisteme rregullatore për zvogëlimin e rreziqeve në të gjithë sektorët me interes në nivel lokal, standardet teknike dhe PSO.
- › **Krijimi i mekanizmave institucionalë** që duhet të ndjekin qasjen se zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa është përgjegjësi e shoqërisë në tërësi (ang. whole-of-society approach) dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes (ang. whole-of-government). Në kontekstin tonë, kjo do të thotë se përgjegjësia nuk është vetëm e Qendrës për Menaxhim me Kriza me qendrat e saj rajonale dhe Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim me zyrat e saj rajonale. Përkundrazi, zvogëlimi i rreziqeve është detyrim i të gjitha subjekteve dhe të gjithë sektorëve në nivel vendor. Në bazë të akteve ligjore kompetente është e nevojshme të kenë krijuar një strukturë të brendshme të përshtatshme që do të zbatojë detyrimet ligjore, por edhe do të kontribuojë në përfshirjen e gjithanshme në sektorët përkatës, si dhe aktorë të tjerë, qytetarët, sektori privat, akademia dhe OJQ-të përmes integritit në dokumentet strategjike, programore dhe planifikuese dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve. Gjithashtu, bazuar në këtë parim, duhet të sigurohet një koordinim efikas dhe efektiv për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rikuperimin nga fatkeqësitë dhe krizat, duke forcuar organet dhe mekanizmat

23. Parimet për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në rrjedhat kryesore dhe fushat e zhvillimit lokal, bazohen në grupin përkatës të parimeve në publikimin e UNESKAP-s: UNESCAP. Mainstreaming Disaster Risk Reduction for Sustainable Development: A Guidebook for the Asia-Pacific. 2017. fq.13-22. [Online [https://www.unescap.org/sites/default/files/publication\\_WEBdrr02\\_Mainstreaming.pdf](https://www.unescap.org/sites/default/files/publication_WEBdrr02_Mainstreaming.pdf)]

ndërministror në nivel lokal. Krijimi i mekanizmave institucionalë i referohet përfshirjes së subjekteve dhe palëve të ndryshme si në proceset dhe procedurat në fazat e ndryshme të ciklit të fatkeqësive, ashtu edhe në pjesëmarrjen e tyre në organet operationale në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Kjo gjithashtu do të sigurojë që nevojat e tyre të merren parasysh gjatë ballafaqimit, reagimit dhe rikuperimit nga katastrofat.

- › **Miratimi i politikave dhe planifikimi i kornizës** - Ky parim duhet të konsiderohet në prizmin e miratimit të strategjive, programeve dhe planeve, si në segmentin e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa ashtu edhe në dokumente të veçanta sektoriale. Këtu është e nevojshme të sigurohet konvergjenca e dy fushave, përkatësisht zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa të përfshihet në dokumentet lokale dhe sektoriale dhe prioritetet dhe objektivat sektoriale që njihen dhe përfshihen në strategjitë, vlerësimet, planet dhe dokumentet e tjera për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. Rekomandohet, këto politika, masa dhe aktivitete të integrohen në planet e tyre të veprimit, të cilat do të përcaktojnë aktivitete realiste, të arritshme, të mbështetura financiarisht dhe gjithëpërfshirëse në nivel lokal.
- › **Ofrimi i mbështetjes financiare dhe buxhetore** - Qasja dhe disponueshmëria e burimeve financiare dhe mbështetjes buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes lokale është një temë që meriton analizë të veçantë dhe qasje strategjike. Duke pasur parasysh kufizimin e mekanizmave financiarë në dispozicion dhe planifikimin e kufizuar buxhetor, mungesa e mjeteve për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa është e dukshme. Karakteristika të tjera janë financimi reaktiv i masave dhe aktiviteteve pas ndodhjes së ngjarjes/katastrofës, për shembull kompensimi i dëmeve. Mjetet për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese dhe të mundshme janë të pamjaftueshme dhe buxhetet lokale “nuk kanë mjete të alokuara në mënyrë specifike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa”.<sup>24</sup> “Nuk ka zëra të veçantë për menaxhimin me kriza në buxhetet e komunave, megjithëse për disa aktivitete të ndërlidhura në segmentet e parandalimit, menaxhimit dhe rivitalizimit, shpenzimet e parashikuara mund të identifikohen.”<sup>25</sup> Nga ana tjetër, ka përfshirje të pamjaftueshme të vlerësimeve të rreziqeve dhe kërcënimeve dhe modaliteteve të rrezikut të politikave, programeve dhe planeve strategjike dhe sektoriale në nivel kombëtar dhe lokal, për shembull sigurimi nga rreziqet natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu. Kjo ndikon në nivelin e zhvillimit të partneriteteve publiko-privat, iniciativave private për zvogëlimin e rreziqeve dhe përdorimin e mekanizmave financiarë novatorë. Gjithashtu, edhe pse Korniza Sendai i referohet krijimit dhe financimit të rrjeteve mbrojtëse të sigurimeve shoqërore në rast të katastrofave dhe emergjencave, ato nuk përdoren ende në shtet për shkak të mungesës së kuadrit

24. UNDP. Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report for Former Yugoslav Republic of Macedonia. 2011. Online <https://www.cadri.net/system/files/2021-06/FYR-Macedonia-DRR-Capacity-Assessment-Report-2011.pdf>

25. Popovski, Vasko. Studim për politika publike për menaxhim me kriza. IDSCS. 2021. fq. 27. Online <https://idscs.org.mk/mk/2021/03/26/студија-за-јавни-политики-за-управува>

financiar dhe tematik. Për shkak të gjithë kësaj **nevoja për financim më të mirë për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal**, nëpërmjet financimit buxhetor më të madh, më të mirë dhe të qëndrueshëm, shfrytëzimit më të madh të mekanizmave dhe skemave financiare ekzistuese dhe novatore, si dhe përfshirjes më të madhe të sektorit privat, veçanërisht në segmentin e transferimit të rrezikut dhe financimit të rezistencës të infrastrukturës kritike lokale. Gjithashtu, procedura e krijimit të politikave buxhetore në nivel lokal dhe përgatitja e buxheteve vjetore duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, si në përcaktimin e prioritetëve të masave dhe aktivitetëve për zvogëlimin e rreziqeve, ashtu edhe në financimin e nevojave të grupeve të rrezikuara të qytetarëve, me çka do të rritet qëndrueshmëria e tyre.

- ▶ **Decentralizimi i përgjegjësive në nivel lokal** shfaqet si një domosdoshmëri, veçanërisht gjatë krizës së pandemisë COVID-19. “Menaxhimi i krizës është një kompetencë e centralizuar, kurse mbrojtja dhe shpëtimi është një kompetencë e përbashkët, prandaj është i nevojshëm decentralizimi i mëtejshëm i kompetencave qendrore, si dhe vendosja e kompetencave të reja në mënyrë që komunat të kenë mekanizma, burime dhe kapacitete të plota për parandalim, reagim dhe rikuperim rrezistent. E gjithë kjo duhet të shoqërohet me sigurimin dhe transferimin e burimeve të përshtatshme financiare dhe njerëzore. Vetëm në këtë mënyrë komunat do të jenë efikase dhe efektive në zbatimin e parandalimit dhe me kohë tu përgjigjen rreziqeve në zonën e tyre.”<sup>26</sup> Decentralizimi i mëtejshëm i këtyre kompetencave do të kontribuojë në reduktimin në kohë, më efikas dhe efektiv të rreziqeve nga katastrofa përmes përmirësimit të qeverisjes lokale, gjithë përfshirjes dhe pjesëmarrjes së subjekteve dhe qytetarëve, veçanërisht grupeve të rrezikuara, ndërkohë që do të kontribuojë drejtpërdrejt në njësitë e vetëqeverisjes lokale të luajnë rolin e subjekteve të para që merren me kriza dhe katastrofa (angl. first responders), por edhe të jenë entitetet e para që parandalojnë katastrofat dhe fatkeqësitë e ardhshme (angl. first preventers). Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se rreziqet nuk i njohin kufijtë komunalë, është e nevojshme të zgjerohet segmenti i bashkëpunimit ndër-komunal, si në aspektin e kompetencave të ndara ashtu edhe në drejtim të burimeve të nevojshme për parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rikuperimin, bazuar në rreziqet e profilizuara dhe rreziqet e vlerësuara për komunat e caktuara.”<sup>27</sup>
- ▶ **Ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet** - Së bashku me përmirësimin e burimeve ekzistuese, ngritja e kapaciteteve është një nga elementët bazë të përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planifikimin e zhvillimit lokal. Realizohet në mënyrë të dyanshme, si në subjektet e sistemit ashtu edhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Është e nevojshme të adresohen të gjitha rreziqet,

26. Popovski, Vasko. Studim për politika publike për menaxhim me kriza. IDSCS. 2021. fq. 29. Online <https://idscs.org.mk/mk/2021/03/26/студија-за-јавни-политики-за-управува/>

27. Idid, fq 29.

kërcënimet dhe sektorët dhe të mbulohen aspektet e të dyja palëve, me qëllim njohjen e mundësive për integrim, si dhe zbatimin e tyre nëpërmjet dokumenteve strategjike dhe masave dhe aktiviteteve praktike. Ngritja e kapaciteteve duhet të jetë në bosht horizontal (për të përfshirë të gjitha subjektet në nivel lokal) dhe në një bazë vertikale (jo vetëm për të përfshirë subjektet në nivel kombëtar, por edhe për të identifikuar dhe forcuar kapacitetet sipas marrëdhënieve të njohura dhe të vendosura dhe burimet). Aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve mund të mbulojnë një gamë të gjerë subjektësh dhe praktikash. Këto përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe senzibilizim për rezistencën dhe përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa për politikëbërësit në nivel kombëtar dhe lokal, ekspertë nga palët e interesuara dhe praktikuesit dhe qytetarët. Prandaj, ngritja e kapaciteteve mund të realizohet përmes ngritjes së vetëdijes së përgjithshme dhe zbatimit të aktiviteteve edukative apo edukimit dhe trajnimit profesional të personave që merren me menaxhimin e katastrofave.

### 2.3 Kuadri global dhe kombëtar për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në zhvillimin lokal

Në kuadrin global të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në agjendat e qeverive kombëtare dhe lokale është identifikuar me **Kornizën për Veprim të Hyogo 2005 - 2015** (Anglisht Hyogo Framework for Action 2005 - 2015) dhe për herë të parë u identifikuan shtatë parime<sup>28</sup> për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, përkatësisht: mekanizmin institucional dhe ligjor, integrimin në politikat dhe planifikimin e zhvillimit, financimin, decentralizimin, ngritjen e kapaciteteve dhe vullnetin politik. Në fakt, është pjesë e agjendës për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent. Për shembull, **Korniza për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa Sendai 2015 - 2030** identifikon masat dhe nxitësit kryesorë të katastrofave. Në kornizë thuhet se “aksioni i përkushtuar duhet të fokusohet në ballafaqimin me promotorët kryesorë të rrezikut nga katastrofa, siç janë pasojat nga varfëria dhe pa barazia, ndryshimet klimatike dhe variabiliteti, urbanizimi i pa planifikuar dhe i shpejtë, menaxhimi i keq me tokën dhe faktorë kompleks, siç janë ndryshimet demografike, aranzhimet e dobëta institucionale, politikat që nuk janë të informuara për rrezikun, mungesa e rregullativës dhe stimulime për investime private për zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, zinxhirë kompleks të furnizimit, qasje e kufizuar e teknologjisë, shfrytëzim i pa qëndrueshëm i burimeve natyrore, ekosisteme të zvogëluara,

28. Komiteti Social dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin, <https://www.unescap.org/sites/default/d8files/knowledge-products/Mainstreaming%20DRR%20in%20Development%20Planning%20and%20Finance%20by%20P.G%20Dhar%20Chakrabarti.pdf>.

pandemi dhe endemi”.<sup>29</sup> Në nivel operacional, ky kuadër ka disa veçori: udhëheq me menaxhimin e shumëfishtë të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofa në të gjitha nivelet nëpër të gjithë sektorët dhe është e nevojshme të integrohet përmes të gjitha politikave, planeve, programeve dhe buxheteve në të gjitha nivelet. Përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planifikimin e zhvillimit është përgjegjësi e të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara, duke përfshirë edhe sektorin privat në të gjitha nivelet. Në kuadër të **Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm**, zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa nuk paraqitet si synim më vete por integrohet në strukturën e qëllimeve individuale dhe kontribuon në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rezistent, ku ekziston mundësia e përfshirjes sistematike dhe gjithëpërfshirëse të tij në sektorë dhe fusha të ndryshme në të gjitha nivelet. “Fokusi i zbatimit ofron një mundësi për të inkurajuar rritjen e angazhimit politik dhe investimeve ekonomike për zvogëlimin e rreziqeve dhe për të ndërmarrë aktivitete zhvillimore që e konsiderojnë qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive si kryesore për reduktimin e varfërisë dhe një shtytës kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm”.<sup>30</sup> Marrëveshja e Parisit nuk e përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë përfshirje, por i referohet njohjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, për shkak të rëndësisë së saj të përgjithshme në parandalimin, minimizimin dhe trajtimin e humbjeve dhe dëmeve që lidhen me efektet negative të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë ngjarjet ekstreme të motit dhe ngjarjet me fillim të ngadaltë dhe rolin e zhvillimit të qëndrueshëm në uljen e rrezikut nga humbjet dhe dëmet.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa zbatohet në mënyrë gjithëpërfshirëse përmes sistemeve të menaxhimit me kriza dhe mbrojtje dhe shpëtim, si dhe përmes kompetencave dhe fushave të tjera të njësive të vetëqeverisjes lokale. Në **nivel kombëtar dhe lokal**, nuk ka kornizë adekuate strategjike apo kornizë politike për të adresuar nevojën për përfshirje më të gjerë në zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa sipas Kornizës Sendai nuk është miratuar, ndërsa Strategji Kombëtare për mbrojtje dhe shpëtim është duke u hartuar dhe ende nuk është shpërndarë publikisht. Në nivel rajonal ekzistojnë strategji zhvillimore për zhvillimin rajonal të tetë rajoneve planore në të cilat janë integruar masa dhe aktivitete të caktuara. Megjithatë, nuk mund të bëhet fjalë për një qasje sistematike apo të integruar, por më shumë për aktivitete individuale ku aspekte të caktuara të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa përfshihen në zhvillimin rajonal, përkatësisht zhvillimi i programeve rajonale për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa,<sup>31</sup> masat për menaxhimin e rrezikut nga katastrofa natyrore,<sup>32</sup> mbrojtjen

29. Korniza për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa Sendai 2015 - 2030 <https://sustainabledevelopment.un.org/frameworks/sendai-framework>

30. Disaster risk reduction and resilience in the 2030 agenda for sustainable development. UNDRR, 2015. I qasshëm në: <https://www.un-escap.org/sites/default/d8files/knowledge-products/Mainstreaming%20DRR%20in%20Development%20Planning%20and%20Finance%20by%20P.G.%20Dhar%20Chakrabarti.pdf>.

31. Programi për zhvillimin e rajonit planor të Vardarit 2021 - 2026, në dispozicion në: <https://vardarregion.gov.mk/web/wp-content/uploads/2021/08/Programa-za-Razvoj-na-Vardarski-Planski-region-2021-2026.pdf>

32. Programi për zhvillimin e rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026. I qasshëm në: <https://southwestregion.mk/web/wp-content/uploads/2021/07/FinalnaPrograma-JUGOZAPADEN-Planski-Region-2021-2026.pdf>

nga rreziqet natyrore,<sup>33</sup> zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike duke përfshirë katastrofat për shkak të motit të keq.<sup>34</sup> Në nivel lokal, miratimi i planeve strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, është risi. Duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal dhe në përmbushjen e një prej objektivave të Kornizës Sendai, që është Objektiv E: “Rritja e konsiderueshme e numrit të vendeve me strategji kombëtare dhe lokale për zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa deri në vitin 2020.” Po ashtu, vendosen bazat për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent. Planet strategjike janë zhvilluar për tetë njësi të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht Konçe, Karbinci, Kavadar, Veles, Mavrovë-Rostushe, Qyteti i Shkupit, Gostivar dhe Kërçovë.<sup>35</sup> Paralajmëruet i këtyre planeve të specializuara strategjike është strategjia komplekse dhe gjithëpërfshirëse për ndryshimet klimatike të Qytetit të Shkupit, “Shkupi rezistent - Strategjia për ndryshime klimatike”<sup>36</sup> i cili ishte i pari ku përveç sektorit të ujit dhe përmbytjeve, zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa u identifikua si një nga sektorët më të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Përshtatja dhe aktivitetet përkatëse u identifikuan përmes menaxhimit të përmirësuar të rrezikut dhe rritjes së rezistencës urbane. Kjo nënkupton miratimin e një Plani të Integruar Veprimi për Rezistencën Urbane, vendosjen e praktikave për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në Planin e Përgjithshëm Urban dhe strategjitë, programet dhe planet e tjera sektoriale, përmirësimin e parandalimit urban, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga katastrofa. Gjithashtu, zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është identifikuar si një nga sektorët e rrezikuar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe pjesë e Komunikatës së Tretë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike.<sup>37</sup> Do të jetë pjesë e Planit të Katërt, si dhe Planit Kombëtar të Përshtatjes që do të përgatitet, për sa i përket humbjeve dhe dëmeve nga fatkeqësitë e ndryshimeve klimatike.

33 Programi për zhvillimin e rajonit planor Lindor 2021 - 2026. I qasshëm në: [https://eastregion.mk/wp-content/uploads/2022/02/Програма-за-развој-на-Источен-плански-регион-2021-2026\\_v2\\_2.pdf](https://eastregion.mk/wp-content/uploads/2022/02/Програма-за-развој-на-Источен-плански-регион-2021-2026_v2_2.pdf)

34 Programi për zhvillimin e rajonit planor të Pollogut 2021 - 2026. I qasshëm në: [https://rdcpolog.mk/web/wp-content/uploads/2021/08/Програма-за-развој-на-Полошки-плански-регион-2021-2026-финална-нацрт-верзија\\_8.4.2021-1.pdf](https://rdcpolog.mk/web/wp-content/uploads/2021/08/Програма-за-развој-на-Полошки-плански-регион-2021-2026-финална-нацрт-верзија_8.4.2021-1.pdf)

35. Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup, Planet strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga aksidentet dhe fatkeqësitë. I qasshëm në: <https://idscs.org.mk/mk/2022/02/01/стратешки-планови-за-намалување-на-ри>

36. Strategjia e Ndryshimeve Klimatike Shkupi rezistent, <https://skopje.gov.mk/media/4051/resilient-skopje-strategy-eng.pdf>

37. Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, <https://unfccc.int/sites/default/files/resource/mkdnc3.pdf>



Një hap në këtë kontekst është Programi për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021 - 2026<sup>38</sup> i sapo miratuar me Plan Veprimi për periudhën 2021 - 2023<sup>39</sup> i cili “mbulon të gjitha aspektet e rëndësishme të procesit të decentralizimit që kontribuojnë në harmonizimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale me kriteret normative, institucionale dhe standardet politike dhe administrative të BE-së dhe arritjen e synimeve për zhvillim të qëndrueshëm të OKB-së”.<sup>40</sup> Për herë të parë, aspektet e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal janë përpunuar dhe përfshirë në mënyrë sistematike për të rritur rezistencën ndaj katastrofave. Për shembull, një nga prioritetet për zhvillimin lokal në periudhën e ardhshme është Prioriteti 4.4: Përmirësimi i mbrojtjes së popullatës nga kriza dhe katastrofa. Sipas këtij prioriteti, “angazhim kryesor për periudhën e ardhshme është krijimi i një sistemi kombëtar efikas dhe funksional për parandalimin, paralajmërimin e hershëm, gatishmërinë, reagimin dhe rikuperimin nga fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, në të cilin komunat do të marrin pjesë sipas kompetencave të përcaktuara dhe të forcuara qartë dhe përgjegjësisive dhe me kapacitet dhe burime të mjaftueshme.”<sup>41</sup> Të gjitha masat e parashikuara të këtij prioriteti kanë në vetvete dimensionin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa. Masa 1.1.3 Miratimi i strategjive për qëndrueshmërinë e qyteteve përmes zhvillimit të politikave, masave dhe aktiviteteve gjithëpërfshirëse për transformim dhe përshtatje konkretisht i referohet planeve strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa përgatitja e dokumenteve për qëndrueshmërinë e qyteteve.

Në nivel normativ, në bazë të nenit 5 të LMK, njësitë e vetëqeverisjes lokale në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj, kanë detyrim për nevojat e tyre, për parandalim efektiv dhe paralajmërim të hershëm të situatës së mundshme të krizës, të vlerësojnë rreziqet dhe kërcënimet në nivel lokal. Komunat duhet të identifikojnë nevojat dhe të planifikojnë burimet dhe të zbatojnë vendimet e qeverisë në lidhje me menaxhimin e krizave në zonën e tyre. Vlerësimin e kërcënimeve për komunën ose qytetin e Shkupit e përgatit Qendra kompetente rajonale për menaxhim me kriza. Në ballafaqimin me krizën, kryetari i komunës ose qytetit të Shkupit siguron koordinimin e pjesëmarrësve në sistemin për menaxhim me kriza në nivel lokal. Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit u krijua në 2004. për të mbrojtur popullsinë, mjedisin, të mirat materiale, burimet natyrore, biodiversitetin dhe trashëgiminë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në paqe, gjendje të jashtëzakonshme dhe luftë. Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë kompetenca të caktuara sipas Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim, si kompetenca të përgjithshme dhe kompetenca të Këshillit të Komunës dhe Kryetarit të komunës.<sup>42</sup> Më të rëndësishmet

38 Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Programi për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim 2021 - 2026 [https://mls.gov.mk/images/files/Akciski%20plan%20mk%20\(1\).pdf](https://mls.gov.mk/images/files/Akciski%20plan%20mk%20(1).pdf)

39 Ibid

40. Ibid, f. 3..

41. Ibid, f. 43

42. Kompetencat e NJVL-së janë obligime të përgjithshme që burojnë nga Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (tekst i konsoliduar), ndërsa kompetencat e Këshillit të komunës dhe Kryetarit të komunës përcaktohen nga nenet 34, 35 dhe 36 të Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim (tekst i konsoliduar).

prej tyre janë miratimi i vlerësimit të kërcënimeve dhe dokumentacionit planor për mbrojtje dhe shpëtim, krijimi i forcave hapësinore për territorin e komunës, si dhe themelimi i shtabit komunal për mbrojtje dhe shpëtim. Megjithatë, në të dyja zgjidhjet ligjore nuk bëhet fjalë për vendosjen e bazave për përfshirjen specifike të zonave në zhvillimin lokal.

Situata është e ngjashme me aktet të tjera ligjore të sektorëve kryesorë, duke pasur parasysh faktin se zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa nuk përfshihet plotësisht në ligjet kryesore (sektorët: bujqësia, uji, pyjet, mjedisi, planifikimi urban dhe ndërtimi) dhe shumica e tyre janë ende akte ligjore që janë të verbër dhe nuk njohin zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. Qasja aktuale është të përfshijë identifikimin e aktiviteteve dhe zgjidhjeve, në vend që të përfshijë në mënyrë sistematike dhe të integruar zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, si modus operandi për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent kombëtar dhe lokal. Për më tepër, “Metodologjia e zhvilluar së fundi për përfshirjen e mendimeve për ndryshimet klimatike në planifikimin hapësinor me fokus në planin kombëtar hapësinor”<sup>43</sup> ofron një mjet inovativ se si të rishqyrtohet në mënyrë holistike planifikimi tradicional hapësinor dhe urban duke marrë parasysh rreziqet, dobësitë plotësuese ose ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Në përmbledhje, mangësitë dhe zbrazëtitat e mëposhtme<sup>44</sup> mund të identifikohet në përfshirjen ekzistuese të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planifikimin e zhvillimit, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal: mungesa e një kuadri strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa që mund të vendosë bazat sociale për zhvillimin rezistent; ndërjegjësim dhe kuptim i ulët për zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa midis politikëbërësve dhe vendimmarrësve; bashkëpunim dhe koordinim i pamjaftueshëm ndërmjet subjekteve në fjalë; njohuri të pamjaftueshme për rëndësinë dhe modalitetet e përfshirjes në politikat kryesore; mungesa e politikave dhe udhëzimeve teknike për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në politikat kyçe për planet dhe sektorët e zhvillimit në nivel kombëtar dhe lokal; kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe organizative në subjektet kompetente; arsimim dhe specializim i pamjaftueshëm profesional; mungesa e përfshirjes dhe pjesëmarrjes në miratimin e politikave, programeve dhe planeve. Nisur nga kjo, ky dokument synon të propozojë zgjidhje praktike se si të realizohet përfshirja në nivel lokal.

Në **përballjen me krizat**, komuna:

- monitoron gjendjet, veprimet dhe dukuritë që mund të rezultojnë me krizë në komunë;
- bën vlerësim të cenimit nga rreziqet dhe kërcënimet për shfaqjen e një situatë krize në territorin e komunës;
- miraton program për revitalizimin e komunës pas eliminimit të krizës;
- vendos për lartësinë e mjeteve për menaxhim me kriza nga buxheti.

43. Metodologjia për zbatimin e aspekteve të ndryshimeve klimatike në planifikimin hapësinor me fokus në planin kombëtar hapësinor, <https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/40db321ed2ac26536dda473b3556686a416522bf669183d764ad723fd1070665.pdf>

44. Këto mangësi dhe boshllëqe janë identifikuar në anketën rajonale për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, të kryer gjatë mesit të vitit 2021 për nevojat e Zyrës Rajonale të UNDP-së për Evropë dhe Azi Qendrore dhe janë publikuar në një dokument të brendshëm: Popovski, Vasko. Development of the Guidance Notes on DRR Mainstreaming in the National Development Plans (Review Report). 2021.

# 3. PËRFSHIRJA E ZVOGËLIMIT TË RREZIQEVE NGA KATASTROFA NË PLANIFIKIMIN STRATEGJIK NË NIVEL LOKAL

## 3.1 Hyrje

Pika fillestare për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal fillon me ndërveprimin dhe integrimin e zonës në planifikimin dhe programimin strategjik. Ky është rasti qoftë për strategjitë e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal, strategjitë e zhvillimit të njësisve të vetëqeverisjes lokale apo strategjitë për zhvillimin e sektorëve në nivel lokal. Në parim, procesi i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është i ndërlikuar dhe duhet të ketë një renditje dhe realizim logjik, ndërkohë që njësitë e vetëqeverisjes lokale zbatojnë mënyrat e përcaktuara sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre.




Figura 3 - Procesi dhe mënyrat e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal<sup>45</sup>

Megjithatë, planet strategjike për zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa janë mjeti kryesor për përfshirjen e zonës në zhvillimin lokal, duke bashkuar aspektet, karakteristikat, prioritetet e saj të ndryshme. Në mungesë të udhëzimeve të detajuara për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal, kjo është ndoshta mënyra më e thjeshtë dhe më efektive. Niveli tjetër është vendosja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në plane dhe programe të tjera strategjike, që nënkupton një ndërgjegjësim të caktuar për nevojën, modalitetet dhe prioritetet, si dhe mënyrën e zbatimit të politikave dhe masave rezistente. Së fundi, niveli i fundit, teknikisht më i ndërlikuari, është përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në kompetenca dhe sektorë individualë, si në aspektin e specifikave teknike, ashtu edhe në kuptimin e nevojës për lidhje intensive vertikale të pushtetit kombëtar dhe lokal me segmentin e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa dhe sektorëve të lidhur. Vendosur në kontekst (shih Figurën 4), planet strategjike në nivel lokal janë baza për miratimin e programeve dhe planeve sektoriale. Baza e tyre e përbashkët është zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa si një segment kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm dhe rezistent lokal.

45. Diagrami i procesit bazohet në një diagram të ngjashëm procesi në publikimin e UNESCAP: UNESCAP. Mainstreaming Disaster Risk Reduction for Sustainable Development: A Guidebook for the Asia-Pacific. 2017. fq.24. [Online] [https://www.unescap.org/sites/default/files/publication\\_WEBdrr02\\_Mainstreaming.pdf](https://www.unescap.org/sites/default/files/publication_WEBdrr02_Mainstreaming.pdf)

Figura 4 - Kontekstualizimi i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal



### 3.2 Udhëzime për miratimin e planeve strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

Planifikimi strategjik në nivel lokal është një nga hapat e parë dhe më të thjeshtë në përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në zhvillimin lokal. Ndonëse nuk është përcaktuar nga legjislacioni ekzistues në lidhje me fushën shumë sektoriale të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, sërish është një mundësi e shkëlqyer për të nisur procesin gjithëpërfshirës dhe për të përcaktuar në mënyrë specifike zhvillimin strategjik të komunës në afat të mesëm. Këto plane ofrojnë një bazë për zhvillimin e një qasjeje për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal, si dhe për marrjen e shumë masave dhe aktiviteteve që janë realiste, praktike dhe të zbatueshme dhe që do të forcojnë më tej qëndrueshmërinë e komunave dhe qytetarëve ndaj rreziqeve ekzistuese dhe të reja në territorin e komunës. Vizioni është që qytetet dhe komunat të përshtaten me ndryshimet klimatike duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent, duke përfshirë menaxhimin e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa. Në të njëjtën kohë, duhet të mundësohet përmirësimi i menaxhimit lokal të rrezikut nëpërmjet zbatimit të masave dhe aktiviteteve, me përfshirjen dhe mbështetjen e plotë të subjekteve dhe komunitetit. Planet strategjike të përgatitura për zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa deri më tani bazohen në parimet e mëposhtme:<sup>46</sup>

**a) Parimi i përparësisë:** zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është një prioritet kombëtar dhe lokal.

**b) Parimi i veprimit të integruar:** Masat dhe aktivitetet e zbatuara për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa bazohen në kuadrin normativ, institucional dhe programor të subjekteve në sistemin për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa.

**c) Parimi i bashkëpunimit ndërsektorial:** Zbatimi i planit strategjik bazohet në procedurat operacionale, komunikimin, koordinimin dhe bashkëpunimin e

46. Komuna e Kavadarit. Plani strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. 2021. fq.11-12. Online. <https://idsos.org.mk/wp-content/uploads/2021/10/kavadarci.pdf>

subjekteve të cilët marrin pjesë në zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa dhe kryhet në frymën e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërsektorial.

**d) Parimi i barazisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut:** Në kuadër të realizimit të Planit Strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa për zonën e Komunës, do të kujdeset që të respektohet parimi i barazisë gjinore dhe asnjë masë apo aktivitet nuk duhet të rrezikojë këtë parim. Gjithashtu, masat dhe aktivitetet duhet të bazohen në respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të jenë të qasshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve, duke përfshirë grupet e rrezikuara (gratë, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, të moshuarit, komunitetet etnike).

**e) Parimi i informimit të publikut:** Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale në përputhje me procedurën e përcaktuar me kohë dhe plotësisht, do ta informojë publikun për aspektet e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofa, informatat dhe të dhënat përkatëse për rreziqet dhe kërcënimet, si dhe masat dhe aktivitetet për mbrojtje nga pasojat e tyre, reagimin dhe rimëkëmbjen, duke përfshirë dhe qytetarët.



Figura 5 - Fazat e përgatitjes së planit strategjik të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa

Në diagramin e mësipërm janë paraqitur fazat në ciklin e përgatitjes së planit strategjik për zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa e njësisive të vetëqeverisjes lokale. Fazat duhet të jenë komplementare me prioritetet e zhvillimit strategjik komunal, por edhe në përputhje me kornizën normative ekzistuese, si dhe qëllimet dhe prioritetet e Kornizës Sendai 2015 - 2030 dhe kornizave të tjera globale ose rajonale për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent. Rrjedhimisht, udhëzimet për përgatitjen e planit strategjik për zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa do të ishin si më poshtë:

## Faza 1 - Përgatitja dhe planifikimi i procesit

Në këtë fazë realizohen aktivitetet fillestare dhe përgatitore lidhur me planin strategjik për zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa, të cilat njësia e vetëqeverisjes lokale i ndërmerr në bashkëpunim me institucionet dhe organet kompetente në nivel kombëtar dhe rajonal. Rekomandohen udhëzimet e mëposhtme:

- › ***Krijimi i një ekipi koordinues të projektit*** i cili do të sigurojë komunikim, koordinim dhe bashkëpunim adekuat, në kohë, efikas dhe efektiv ndërmjet të gjitha subjekteve, organizatave dhe individëve të përfshirë. Nga kryetari i komunës duhet të caktohet koordinatori për përgatitjen dhe zbatimin e planit strategjik (zakonisht është personi që përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e sektorëve në segmentin e zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa). Koordinatorin i caktuar në bashkëpunim me pjesët tjera të administratës komunale dhe të tjerët do të sigurojë: koordinimin e të gjithë procesit dhe grupit punues për përgatitjen dhe zbatimin e dokumentit; monitorimin dhe raportimin për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planit; përgatitjen e raporteve; iniciimin e procedurës për përditësimin e planit; si dhe gjëra të tjera të përcaktuara nga kryetari i komunës dhe këshilli i komunës që nevojiten për realizimin e planit. Ekipi duhet të përbëhet nga ekspertë të sektorëve dhe fushave të ndryshme, bashkëpunëtorë të jashtëm, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht grupeve të rrezikuara, sektorit privat dhe akademik.
- › ***Përcaktimi i një vizioni të përbashkët për zhvillimin e NJVL-së*** që korrespondon me vizionin dhe synimet për zhvillimin e tij, përmes sigurimit të zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa drejtpërdrejt dhe tërthorazi, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të parashikuara për të kontribuar në përmbushjen e vizionit.
- › ***Lidhja vertikale dhe horizontale e planit strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa me kuadrin përkatës të politikave globale, kombëtare dhe lokale dhe kuadrin normativ*** - Plani strategjik bazohet në kuadrin ligjor ekzistues të zonës shumë sektoriale të zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa dhe monitoron dokumentet, programet dhe planet strategjike globale, kombëtare, rajonale dhe lokale.
- › ***Kuadri normativ dhe institucional për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal*** - Kompetencat identifikohen sipas kuadrit normativ ekzistues dhe identifikohen institucionet që janë pjesë e zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal, së bashku me aktorë të tjerë në nivel lokal, për shembull kompanitë me rëndësi të veçantë, sektori privat, organizatat e shoqërisë civile, sektori akademik. Realizohet analizë funksionale e strukturës dhe kompetencave të njësisë së vetëqeverisjes lokale, si dhe janë aplikuar disa mjete për mbështetjen e planifikimit strategjik, për shembull Analiza SWOT,<sup>47</sup> analiza e palëve të interesuara dhe matrica e rrezikut.

<sup>47</sup> Analiza SWOT nënkupton analizën e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, përkatësisht SWOT S- Strengths W-Weaknesses O-Opportunities T-Threats.

## Faza 2 - Profili i NJVL-së dhe profili i rreziqeve nga katastrofa

Faza e dytë e përgatitjes së planit strategjik i referohet zhvillimit teknik dhe profesional në kuadër të elementeve të rrezikut në zonën e njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe karakteristikave, rreziqeve, elementeve të rrezikut dhe kapaciteteve të sistemit lokal. Kjo përfshin përgatitjen e një matrice të streseve kronike aktuale dhe goditjeve të mundshme akute mbi rezistencën e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Në këtë fazë nevojitet bashkëpunim më i ngushtë me Qendrën për Menaxhim me Kriza dhe Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim dhe qendrat e tyre rajonale dhe njësitë rajonale, si dhe me subjekte të tjera përkatëse për të identifikuar ngjarjet e kaluara dhe humbjet dhe dëmet e shkaktuara, zbatimin e mjeteve dhe dokumenteve ekzistuese, analizën dhe sintezën e të dhënave. Burimet e të dhënave mund të jenë nga publikimet, dokumentet dhe strategjitë komunale, Vlerësimi i rrezikshmërisë në zonën e komunave dhe qytetit të Shkupit nga të gjitha rreziqet dhe kërcënimet, Vlerësimi i rrezikimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera dhe planet për mbrojtje dhe shpëtim, strategjitë sektoriale dhe vlerësime dhe dokumente të tjera.

- › **Profili i NJVL-së** - Seksioni për profilin e njësisë së vetëqeverisjes lokale grumbullon dhe analizontë dhëna që kanë të bëjnë me sipërfaqendhe karakteristikat gjeografike të saj, të dhëna të përgjithshme për NJVL-në, hidrologjinë, pylltarinë dhe tokën dhe qëllimin e saj, kushtet klimatike, karakteristikat demografike dhe banimin, zhvillimin socio-ekonomik, infrastrukturën dhe komunikimet lokale, veçoritë mjedisore dhe arsimin, shëndetësinë dhe kulturën.
- › **Profili i rreziqeve dhe kërcënimeve nga katastrofa** - Konsiston në profilizimin e rreziqeve sipas shkallës së kërcënimit të sigurisë në territorin e komunës ose qytetit të Shkupit, pasqyrën e ngjarjeve katastrofike në dy dekadat e fundit, profilin e rreziqeve dhe pikave të nxehta në territorin e komunës ose të qytetit të Shkupit, dhe analiza e shkurtër e rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese dhe të mundshme.
- › **Matrica e stresit kronik dhe goditjeve akute**<sup>48</sup> - “Kjo matricë synon të kuptojë tendencat e ardhshme të rezistencës së njësisë së vetëqeverisjes lokale duke mbështetur profilizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve, njohjen e ekspozimit dhe rrezikimit dhe faktorët bazë të rrezikut. Streset kronik dhe goditjet akute që ndikojnë mbi realizimin e funksioneve bazë të komunës, si dhe mbi qëndrueshmërinë e komunitetit dhe qytetarëve.”<sup>49</sup>

48. \_Me Stres kronik nënkuptohen ngjarje që përsëriten dhe dobësojnë strukturën urbane të komunave dhe qyteteve në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa goditjet akute nënkuptojnë ngjarje që ndodhin papritur dhe çrregullojnë funksionimin e komunave dhe qyteteve.

49. Komuna e Kavadarit. Plani strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa 2021 - 2025. <https://idsos.org.mk/wp-content/uploads/2021/10/kavadarci.pdf>



### Faza 3 - Vizioni, qëllimi dhe prioritetet strategjike

Plani strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa ka një periudhë planifikimi afatmesëm, por është zhvilluar me një perspektivë afatgjatë që duhet të jetë në përputhje me vizionin për zhvillimin e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Në fakt, vizioni i planit synon zhvillimin e qëndrueshëm dhe rezistent duke përmirësuar menaxhimin e zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa në të gjitha fazat e ciklit të parandalimit dhe zbutjes, paralajmërimit të hershëm, gatishmërisë, reagimit dhe qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive dhe krizave. Ai është i shkurtër, i qartë dhe i kuptueshëm dhe i referohet suksesit që njësia e vetëqeverisjes lokale duhet të arrijë në kontekstin e së ardhmes, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe rezistent. Prandaj, vizioni duhet të përcaktohet në koordinim me ekipin e projektit dhe organet e tjera të qeverisjes lokale dhe palët e interesuara. Qëllimi i planit strategjik i referohet qëllimit dhe rezultatit specifik që duhet të arrihet brenda kornizës kohore të përcaktuar në prioritetet e përcaktuara dhe përmes masave dhe aktiviteteve të përcaktuara. Së fundi, prioritetet strategjike trajtojnë aspektet e ndryshme prioritare të zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa që janë të pranishme në komunë dhe janë të lidhura me prioritetet e Kornizës Sendai. Vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet pjesëmarrja në të gjitha nivelet e qeverisjes, zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa do të jetë përgjegjësi e të gjithëve dhe do të kontribuojë në zbatimin e përgjithshëm të objektivave të Kornizës Sendai. Çdo prioritet strategjik përfshin qëllimet strategjike që përmbajnë një sërë masa dhe aktivitete përmes realizimit të të cilave do të arrihen. Ato identifikohen përmes një procesi konsultativ dhe gjithëpërfshirës së bashku me përfaqësuesit e palëve të interesuara. Në fakt, realizimi i tyre do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirës në partneritet me subjekte në nivel lokal, por edhe sipas nevojave dhe aftësive të të gjithë qytetarëve, duke u kujdesur që të mos anashkalohej asnjë qytetar. Prioritetet bazohen në masa dhe aktivitete që janë realiste dhe pragmatike dhe mund të zbatohen në bazë të mjeteve dhe burimeve në dispozicion të komunës dhe në partneritet me komunat, subjektet, institucionet shtetërore, bashkëpunimin ndërkuftar dhe ndërkombëtar.

### Faza 4 - Plani i veprimit me masa dhe aktivitete

Plani i veprimit përmban masat dhe aktivitetet që janë të nevojshme për zbatim brenda kornizës kohore të përcaktuar për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara dhe për të kontribuar në realizimin e vizionit të përcaktuar. Gjithashtu, në kuadër të masave dhe aktiviteteve individuale, identifikohen bartësit e aktiviteteve dhe institucionet partnere të përgjithshme. Për çdo aktivitet përkufizohet tregues i suksesit/rezultati i pritshëm, afati kohor i zbatimit, si dhe vlerësimi i shpenzimeve për zbatimin e tij dhe burimi i mundshëm i financimit. Aktivitetet mund të jenë strukturore ose jo strukturore. “Masat strukturore janë çdo ndërtim fizik për të reduktuar ose shmangur ndikimet e mundshme nga rreziqet, ose aplikimi i teknikave ose teknologjisë inxhinierike për të arritur rezistencën ndaj rrezikut dhe qëndrueshmërinë në struktura ose sisteme (p.sh.

rregullimi i shtretërve të lumenjve, digave, kanaleve të përrrenjve, zgjidhjeve të bazuara në natyrë,<sup>50</sup> ndërtesa rezistente ndaj tërmeteve, strehimore etj.). Masa të pastruara janë masat që nuk përfshijnë ndërtim fizik që përdorin njohuri, praktikë ose marrëveshje për të zvogëluar efektet dhe rreziqet nga katastrofa, veçanërisht përmes politikave dhe ligjeve, ndërgjegjësimit të publikut, trajnimit dhe edukimit (p.sh. ligjet dhe standardet e ndërtimit, projektet teknike, vlerësimet, kërkime, analiza, fushata publike, aktivitete edukative etj.).<sup>51</sup> Vlerësimi i financimit mund të përcaktohet ose sipas vlerave monetare të përcaktuara afërsisht ose përgjithësisht përcaktohet në tre nivele: *buxhet i vogël* ● / *buxhet mesatar* ● ● / *dhe buxhet i lartë* ● ● ●. Përcaktimi i burimeve financiare të nevojshme përcaktohet në baza vjetore, nëpërmjet buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, buxheteve të subjekteve në nivel kombëtar dhe subjekteve të tjera, nga burime të tjera, si dhe nga pjesëmarrja e donatorëve ose realizimi i projekteve ndërkombëtare.

### Faza 5 - Realizimi i masave dhe aktiviteteve

Masat dhe aktivitetet realizohen në afatin e përcaktuar, nën drejtimin dhe në partneritet me subjektet e përcaktuara. Zbatimi i tyre korrespondon me planet vjetore të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë realizohen të gjitha aktivitetet për mbështetjen e tyre, p.sh. prokurimi publik, lidhja e kontratave, revizionet. Zbatimi i masave dhe aktiviteteve synon të parandalojë krijimin e rrezikut duke reduktimin e rrezikut aktual, si dhe zbutjen e pasojave të dëmshme nga rreziqe të ardhshme dhe potencialisht të reja.

### Faza 6 - Monitorimi, vlerësimi dhe mësimet e nxjerra

Monitorimi, vlerësimi dhe mësimet e nxjerra janë faza e fundit e ciklit të përgatitjes së planit strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. Monitorimi dhe vlerësimi vendoset sipas kuadrit ekzistues në nivel lokal dhe bazohet në vlerat bazë ekzistuese që kanë ekzistuar dhe kanë qenë të qasshme përpara përgatitjes së planit. Përditësimi i vlerave mund të bëhet gjatë rishikimit afatmesëm të planit para përfundimit të vitit të dytë nga miratimi i tij. Monitorimi i planit i referohet mbledhjes dhe përpunimit sistematik të të dhënave për zbatimin e aktiviteteve pa vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin, që është objekt vlerësimi. Këto të dhëna të mbledhura mund të jenë të dobishme për përmirësimin e procesit të vendimmarrjes, informimin e palëve të interesuara dhe sigurimin e kontributit të tyre, si dhe identifikimin e progresit në zbatimin e masave dhe aktiviteteve, identifikimin e vonesave dhe miratimin e strategjive për tejkalimin e tyre, si dhe përditësimin përkatës të kornizës së planit të veprimit. Janë bërë vlerësime për të përcaktuar progresin afatmesëm në zbatimin

50. Zgjidhje të bazuara në natyrë (ang. Nature based Solutions) aktivitete për mbrojtjen, menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e ekosistemeve natyrore ose të modifikuara që trajtojnë në mënyrë efektive dhe efikase sfidat shoqërore (p.sh. ndryshimet klimatike, siguria ushqimore dhe uji ose fatkeqësitë natyrore), duke garantuar mirëqenien njerëzore dhe përfitimet e biodiversitetit. <https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2020-020-Mk.pdf>

51. <https://www.undrr.org/terminology/structural-and-non-structural-measures>

e planit, si dhe suksesin përfundimtar, i cili do të vlerësojë rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë dhe mësimet e nxjerra. Vlerësimi do të marrë parasysh jo vetëm indikatorët e planit, por edhe indikatorët më të gjerë në fushën e menaxhimit me zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunës. Metodologjia përkatëse e vlerësimit do të zbatohet nga vlerësuesi kompetent. Vlerësimet rekomandohen të kryhen nga subjekt për vlerësim të jashtëm. Realizimi dhe monitorimi i përmbushjes së planit do të bëhet nga administrata kompetente e komunës, e caktuar nga kryetari i komunës. Mësimet e nxjerra janë të rëndësishme të mblidhen, analizohen dhe kodifikohen në mënyrë që përmes inkorporimit të tyre të transformohet, të përmirësohet zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal. Në fakt, mësimet e nxjerra ofrojnë dimension shtesë për rezistencën dhe kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa.

### 3.3 Përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet e zhvillimit strategjik lokal

Hapi ose modaliteti tjetër i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në zhvillimin lokal është përmes përfshirjes në strategjitë dhe programet e zhvillimit lokal. Qasja këtu është paksa e ndryshme nga më lartë, pasi kemi qasje të integritit të zvogëlimit të rreziqeve në një kuadër strategjik ekzistues që trajton zhvillimin e përgjithshëm të njësisë së qeverisjes lokale. Siç u tha më lart, shumica e planeve dhe programeve strategjike të zhvillimit në nivel kombëtar dhe lokal nuk përfshijnë segmentin e zvogëlimit të rreziqeve. Nëse përfshihet, ai i referohet vetëm identifikimit të një mase apo aktiviteti individual, jo integritit sistematik dhe ofrimin të mbështetjes për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent lokal. Sipas hulumtimeve të vitit 2018, në numrin e dokumenteve planifikuese të miratuara veçohen vetëm tri komuna: Komuna e Strumicës nga rajoni juglindor me të 19 dokumente, Komuna e Velesit nga rajoni i Vardarit me 14 dokumente planore dhe Komuna e Resnjës nga rajoni i Pellagonisë me 13 dokumente planore. Nga komunat e tjera, shumica janë nën 50% të programeve dhe planeve të miratuara. Neni 22 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale rregullon kompetencat themelore të njësisë të vetëqeverisjes lokale në 13 fusha dhe në kuadër të tyre identifikohen planet dhe programet të cilat konsiderohen themelore dhe të cilat duhet të miratohen dhe zbatohen, si më poshtë:<sup>52</sup>

- › Plani strategjik i komunës;
- › Strategjia për zhvillimin ekonomik lokal;
- › Strategjia për zhvillimin e kulturës;

52. Martin Todevski, Ivana Qurkçieva. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe strategjive dhe menaxhimi me burimet njerëzore në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Qendra për Menaxhim me Ndryshime, Asociacioni për Konsulencë në Menaxhim MKA-2000, Qendra për Gazetari Hulumtuese QGH. 2018. fq.12. Online [https://cup.org.mk/publication/Vtor%20polugodisen%20izvestaj\\_GGV.pdf](https://cup.org.mk/publication/Vtor%20polugodisen%20izvestaj_GGV.pdf)

- › Strategjia për mbrojtjen sociale të qytetarëve;
- › Strategjia për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet;
- › Strategjia për promovimin e barazisë gjinore;
- › Strategjia për të rinjtë;
- › Strategjia për këshillin social ekonomik lokal;
- › Programi për mbrojtje shëndetësore dhe sociale dhe mbrojtje të fëmijëve;
- › Programi i efikasitet energjetik;
- › Programi për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- › Programi për aktivitete lokale;
- › Programi për përgatitjen e planeve urbanistike;
- › Plani i përgjithshëm / i detajuar urban;
- › Program për sport dhe rekreacion;
- › Programi për kulturë;
- › Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personave të shquar me memorialë;
- › Plani veprimi lokal për punësim;
- › Plani për zhvillimin ekonomik të komunës.

Deri më tani, programi dhe plani i aktiviteteve më të përpunuara janë dhënë në Programin e lartpërmendur për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim. Programi ka prioritete dhe aktivitete të planifikuara në të gjitha fazat e ciklit të katastrofave, ndër të cilat më kryesoret janë aktivitetet për përditësimin e vlerësimeve dhe planeve operacionale, përgatitjen e planeve strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa dhe qëndrueshmërinë urbane, përmirësimin e gatishmërisë lokale, forcimin e kapaciteteve profesionale për reagim dhe edukim të qytetarëve, zhvillim i kornizës lokale për rimëkëmbjen të qëndrueshme. Të gjitha këto aktivitete, në një masë më të vogël ose më të madhe, janë të lidhura me planet dhe programet strategjike dhe sektoriale në nivel lokal dhe për këtë arsye është e nevojshme të integrohet zvogëlimi të rreziqeve nga katastrofa në të gjitha fazat e zhvillimit të këtyre dokumenteve dhe në të gjitha aspektet e përmbajtjes. Nisur nga detyrat dhe shtrirja e analizës për përgatitjen e këtij dokumenti, në vijim fokusi do të jetë në programet dhe planet strategjike të zhvillimit. Për programet dhe planet sektoriale është e nevojshme që përfshirja e zvogëlimi të rreziqeve nga katastrofa të realizohet përmes një procesi teknikisht më specifik dhe me përfshirje më të madhe të stafit teknik nga sektorët e zhvillimit në nivel lokal.

Hapi i parë në përfshirjen e zvogëlimi të rreziqeve nga katastrofa është **diagnostikimi i gjendjes ekzistuese** pra përcaktimi i aspekteve dhe gjendjes aktuale me përfshirjen e zvogëlimi të rreziqeve nga katastrofa. Kjo procedurë mund

të kryhet nga vetë njësia e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet personit/personave që mbulojnë këtë fushë dhe në koordinim dhe bashkëpunim me shërbime apo organe të tjera. Mund të krijohet bashkëpunim edhe me qendrat rajonale për menaxhim me kriza dhe njësitë rajonale për mbrojtje dhe shpëtim. Për këtë qëllim është planifikuar të përdoret një mjet i veçantë **Lista teknike për kontrollin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në dokumentet e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit në nivel lokal**. Ky mjet synon të lehtësojë procesin e diagnostikimit duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna të cilat do të realizoheshin në një procedurë gjithëpërfshirëse dhe participative dhe do të përfshinin analizë të dokumenteve dhe të dhënave dhe diskutim të përbashkët të personave të përfshirë. Qëllimi që duhet të arrihet në këtë fazë është të fitohet një pasqyrë e gjendjes aktuale të përfshirjes së fushës, të identifikohen boshllëqet, dobësitë dhe sfidat, si dhe mundësia të nxirren rekomandime për aktivitetet vijuese. Si dhe udhëzimet për përgatitjen e planit strategjik të mësipërm për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, kështu ky mjet dhe udhëzimet që vijnë bazohen në kuadrin kombëtar dhe global për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent.

### Lista teknike për kontrollin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në dokumentet e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit në nivel lokal<sup>53</sup>

#	PYETJE	Po	Aktualisht	Jo	Koment/ shpjegim
Pjesa e përgjithshme: Zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa në nivel loka					
1	A është miratuar Plan strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa apo plan tjetër strategjik në këtë fushë?				
2	A është miratuar ndonjë nga strategjitë e mëposhtme: ndryshime klimatike, rezistencë urbane?				
2.1	Nëse është miratuar ndonjë nga këto strategji, a përfshihet zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa?				
3	A është miratuar dhe përditësuar rregullisht Vlerësimi i rrezikshmërisë në zonën e të gjitha NJVL-ve, nga të gjitha llojet e rreziqeve dhe kërcënimeve				
4	A është miratuar dhe përditësuar rregullisht Vlerësimi për kërcënim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera?				
5	A është miratuar dhe përditësuar rregullisht Plani për Mbrojtje dhe Shpëtim i NJVL-së?				

53. Listat teknike shtohen gjithashtu si bashkëngjitje të veçanta për t'i bërë ato më të qasshme për punë për përdoruesit, në formën e një dokumenti të veçantë ose për printim.


6	A janë miratuar plane operacionale për rreziqe të ndryshme (përmytje, zjarre, etj.)?				
7	A janë hartuar dhe nëse zbatohen hartat për rreziqet dhe kërcënimet për zonën e NJVL-së?				
Pjesa: Planifikimi strategjik dhe zhvillimor në nivel lokal					
8	A është miratuar strategji apo plan strategjik për zhvillimin e NJVL-ve?				
	Nëse është miratuar dokument i tillë, a përfshihet ZKR?				
	Nëse përfshihet ZRK-ja, është evidente, për shembull në profilin e NJVL-së, vizionin, misionin dhe qëllimin, prioritetet, synimet, aktivitetet, buxhetet.				
9	A përfshihet ZRK-ja, në programet dhe planet sektoriale të miratuara?				
	Nëse përfshihet ZRK-ja, kjo është evidente, për shembull në prioritetet, synimet, aktivitetet, buxhetet, etj.				
10	A përdoren vlerësimet nga pikat 3 dhe 4 në përgatitjen e planeve dhe programeve strategjike të zhvillimit?				
11	A përdoren vlerësimet nga pikat 3 dhe 4 në përgatitjen e planeve dhe programeve sektoriale?				
12	A përdoren vlerësimet nga pikat 3 dhe 4 në formulimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore?				
13	A përdoren planet nga pikat 5 dhe 6 në përgatitjen e planeve dhe programeve strategjike të zhvillimit?				
14	A përdoren planet nga pikat 5 dhe 6 në përgatitjen e planeve dhe programeve sektoriale?				
15	A përdoren planet nga pikat 5 dhe 6 në formulimin dhe realizimin e projekteve zhvillimore?				
16	A është e mjaftueshme mbështetja për ZRK-në nga NJVL-ja dhe ZRK është një nga prioritetet në nivel lokal				
17	A ka njohuri të mjaftueshme në NJVL për ZRK-në dhe përfshirjen?				

17.1.	Nëse nuk ka njohuri të mjaftueshme, çfarë duhet të prezantohet apo përmirësohet? (shpjego)				
18	A ka burime të mjaftueshme njerëzore me njohuritë e nevojshme për ZRK-në që mund të marrin pjesë në përfshirjen e ZRK-së në nivel lokal?				
18.1	A ka burime të mjaftueshme materiale dhe teknike dhe burime dhe mjete të TIK për ZRK që mund të kontribuojnë në përfshirjen?				
19	A ka marrë Kryetari i komunës, ndonjë vendim që tregon përfshirjen e ZRK-ve, në programet dhe planet e zhvillimit strategjik apo sektorial në nivel lokal?				
20	A ka marrë Këshilli ndonjë vendim që tregon përfshirjen e ZRK-ve në zhvillimin strategjik apo në programet dhe planet sektoriale në nivel lokal?				
21	A ka ndonjë politikë të miratuar në nivel lokal që adreson ZRK-në dhe mundësinë e përfshirjes lokale?				
22	A zbaton NJVL-ja projekte apo merr pjesë në zbatimin e projekteve që kanë komponentë për përfshirjen e ZRK-së, në nivel lokal?				
23	A ka mekanizma koordinimi efektiv dhe efikas në nivel lokal që mund të kontribuojnë në realizimin e përfshirjes së ZRK-së, në nivel lokal?				
24	Në çfarë mase marrin pjesë institucionet kompetente, qendrat rajonale për menaxhim me kriza dhe njësitë rajonale për mbrojtje dhe shpëtim në zbatimin e ZRK në nivel lokal? A është ajo procedurë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse?				
25	A janë të përfshirë përfaqësuesit e qytetarëve, veçanërisht grupet e rrezikuara në ZRK-të, në nivel lokal dhe në cilat faza dhe procedura?				
26	A është kuadri/struktura ekzistuese institucionale dhe organizative e mjaftueshme për ZRK efikase dhe efektive dhe përfshirjen e saj në nivel lokal?				


Në përputhje me rezultatin e diagnozës, përcaktohet përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal, gjegjësisht në planet dhe programet strategjike të zhvillimit. Këto dokumente duhet të jenë të qarta, koncize, gjithëpërfshirëse për sa i përket profilit aktual, rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese dhe potenciale dhe ndikimit dhe vizionit të dëshiruar, si dhe realiste, praktike dhe të zbatueshme për sa i përket objektivave, masave dhe aktiviteteve.

Në nivel kombëtar, rajonal dhe global, nuk ka shumë udhëzime dhe mjete sistematike për përfshirjen praktike të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planif ikimin strategjik. Kjo është një nga arsyet, krahas politikave dhe kornizave të pamjaftueshme normative, që përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal është e pamjaftueshme, veçanërisht në nivel të sektorëve të ndryshëm dhe planeve dhe programeve përkatëse. Për të përmirësuar situatën në këtë drejtim, si pjesë e përpjekjeve për të krijuar një sistem proaktiv të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, ***në vijim propozohet një grup udhëzimesh*** bazuar në skemën e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet strategjike të zhvillimit në nivel lokal. Në anën e majtë janë dokumentet/procedurat/aspektet e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, dhe në anën e djathtë procedurat për miratimin e planeve dhe programeve strategjike. Çdo fazë e kësaj procedure preferohet të përfshijë një aspekt ose dokument të ndryshëm të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa:

Figura 6 - Skema e përfshirjes së zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet strategjike të zhvillimit në nivel lokal







## Udhëzime për përfshirjen e zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet strategjike të zhvillimit në nivel lokal

- › ***Hyrje në planifikimin dhe programimin strategjik:*** korniza metodologjike, parimet, analiza e situatës së mëparshme - Kjo është faza fillestare e përgatitjes së çdo plani apo programi strategjik apo zhvillimor dhe vetë përfshirja e zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa nis prej saj. Ekipi që punon në miratimin e këtyre programeve dhe planeve, jo vetëm që duhet të jetë profesional, kompetent dhe multisektorial, por duhet përfshirja e ekspertëve të fushës, si nga vetë NJVL-ja, ashtu edhe nga subjektet kompetente apo persona të tjerë të jashtëm, të cilët do të kontribuojnë në përfshirjen e integruar. Nga ana tjetër, kornizat apo politikat strategjike të miratuara, si dhe planet strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa që janë miratuar në një pjesë të NJVL-së, janë bazë për integrimin e disa prej mjeteve dhe parimeve metodologjike. Në analizën e situatës së mëparshme, është e dëshirueshme që të përfshihen fatkeqësitë e kaluara dhe ndikimi i tyre mbi NJVL-në dhe komunitetet, si dëme dhe humbje, si dhe arsye për rritjen e rrezikshmërisë dhe pabarazisë së popullatës, si dhe efektet negative mbi qëndrueshmërinë dhe zhvillim rezistent në nivel lokal.
- › ***Organizimi i NJVL-së, korniza strategjike dhe normative, korniza institucionale*** - Në identifikimin e organizatës dhe vendndodhjes së shërbimeve, organeve dhe institucioneve të NJVL-së, përveç subjekteve ekzistuese, identifikohen dhe përpunohen edhe subjektet kompetente për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa Gjithashtu, janë identifikuar dhe përpunuar kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, përmbushja e të cilave mund të kontribuojë në plotësimin e qëllimeve, por edhe në mbështetjen e zhvillimit lokal. Më tej, analizohet gjendja e kornizës strategjike dhe normative dhe se si ato kanë kontribuar në përmbushjen e qëllimeve dhe si mund të kontribuojnë. Burimet e të dhënave për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa janë korniza strategjike, korniza e politikave dhe korniza normative e ZRK-së, si dhe planet strategjike të miratuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa dhe vlerësimet e rreziqeve dhe kërcënimeve të NJVL-së.
- › ***Integrimi vertikal dhe horizontal*** - Specifikimi se si këto plane dhe programe lidhen me aktet strategjike dhe normative lokale, rajonale dhe kombëtare, si dhe me kuadrin global për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent, si dhe me strategjitë dhe dokumentet e zhvillimit të BE-së. Burimet e të dhënave nga segmenti i zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa janë kornizat strategjike dhe kornizat e politikave dhe planet strategjike të miratuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa
- › ***Analiza e gjendjes aktuale: Profili i NJVL-së, profili i rreziqeve dhe kërcënimeve, SWOT analizat, matrica e streseve kronike dhe goditjeve akute*** - Në këtë fazë të procesit të miratimit të planeve dhe programeve strategjike zhvillimore, kjo fazë është më komplekse sepse vendos bazën për vendosjen e vizionit, qëllimeve, prioritetëve, masave dhe aktivitetëve. Analiza

e gjendjes aktuale duhet të përfshijë profilin e përgjithshëm të NJVL-së, si dhe gjendjen aktuale të zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa dhe ndikimin e tyre potencial në zhvillimin lokal duke identifikuar profilin e rreziqeve dhe kërcënimeve, elementet e rrezikut dhe kapacitetet e sistemit. Qëllimi është të parandalohen pasojat ekzistuese dhe të zbuten pasojat e ngjarjeve të ardhshme. Rrjedhimisht, në kontekstin e analizave specifike, siç është analiza SWOT ose matrica e stresit kronik dhe goditjeve akute, për të parë ndikimin e mundshëm në strukturën e rezistencës së NJVL-së. Këtu është e nevojshme të merren parasysh rreziqet natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, kapacitetet dhe aftësia e subjekteve nga sistemi për të zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, mangësitë dhe dobësitë, sfidat, por edhe forcat dhe mundësitë e tyre për të kontribuar për ndërtimin e komunave rezistente ndaj katastrofave. Në këtë fazë nevojitet bashkëpunim më i ngushtë me Qendrën për Menaxhim me Kriza dhe Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim dhe qendrat e tyre rajonale dhe njësitë rajonale, si dhe me subjekte të tjera përkatëse dhe organizata lokale me qëllim identifikimin e ngjarjeve të kaluara dhe humbjet dhe dëmet e shkaktuara, zbatimin e mjeteve dhe dokumenteve ekzistuese, analizën dhe sintezën e të dhënave. Burime të të dhënave dhe informacioneve të besueshme janë vlerësimet e kërcënimit në zonën e të gjitha NJVL-ve nga të gjitha llojet e rreziqeve dhe kërcënimeve, vlerësimet e kërcënimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planet për mbrojtjen dhe shpëtimin e NJVL-ve, hartat e rreziqeve dhe kërcënimeve, planet operacionale për llojet e ndryshme të rreziqeve natyrore të shkaktuara nga njeriu.

- › **Vizioni, misioni, qëllimet** - Ky është thelbi i planit apo programit dhe drejton ecurinë e zhvillimit afatgjatë lokal me një vizion për shumë vite. Zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa mund të reflektohet në rrugën e zhvillimit afatgjatë të NJVL-ve, përmes mbështetjes për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent, si një nga segmentet e vizionit, misionit dhe qëllimit. Qëllimi i planit strategjik i referohet qëllimit dhe rezultatit specifik që duhet të arrihet brenda kornizës kohore të përcaktuar në prioritetet e përcaktuara dhe përmes masave dhe aktiviteteve të përcaktuara. Burimet e të dhënave nga segmenti i zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa janë kornizat strategjike dhe kornizat e politikave dhe planet strategjike të miratuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa.
- › **Prioritetet strategjike, qëllimet, fushat** - Në dokumentet e zhvillimit, zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa jo vetëm që nuk është përfshirë mjaftueshëm deri tani, por është gjithashtu një temë që nuk është prioritet i veçantë, por mund të shtrihet dhe integrohet në prioritete, qëllime dhe fusha të ndryshme strategjike. Në fakt, është një garanci që nëse integrohet dhe realizohet plotësisht, do të sigurojë që zhvillimi lokal të jetë i vazhdueshëm, pa stres dhe tronditje, dinamik, gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës dhe do të kontribuojë në sigurinë dhe mirëqenien e komuniteteve dhe qytetarëve. Prioritetet strategjike mbulojnë aspektet e ndryshme prioritare të zhvillimit të paraparë afatgjatë të njësisive të vetëqeverisjes lokale. Çdo prioritet strategjik përfshin qëllimet

strategjike që përmbajnë një sërë masa dhe aktivitete përmes realizimit të të cilave do të arrihen. Ato identifikohen përmes një procesi konsultativ dhe gjithëpërfshirës së bashku me përfaqësuesit e palëve të interesuara. Në fakt, realizimi i tyre do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirës në partneritet me subjekte në nivel lokal, por edhe sipas nevojave dhe aftësive të të gjithë qytetarëve, duke u kujdesur që të mos anashkalohet asnjë qytetar. Prioritetet strategjike bazohen në masa dhe aktivitete që janë realiste dhe pragmatike dhe mund të zbatohen në bazë të mjeteve dhe burimeve në dispozicion të komunës dhe në partneritet me komunat, subjektet, institucionet shtetërore, bashkëpunimin ndërkuftar dhe ndërkombëtar. Burimet e të dhënave nga segmenti i zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa janë kornizat strategjike dhe kornizat e politikave dhe planet strategjike të miratuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa.

- ▶ **Plani i veprimit: masat, aktivitetet, projektet, rezultatet, palët e përfshira, shpenzimet**- Plani i veprimit është segmenti i materializimit të vizionit, qëllimeve dhe prioriteteve dhe kjo është ajo që jep thelbin dhe dukshmërinë e dokumentit. Zakonisht deri tani, planet e veprimit nuk kanë njohur aspekte, masa apo aktivitete për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, ose ishin vetëm raste të fragmentuara ose të izoluara, zakonisht pas një ngjarjeje katastrofike,<sup>54</sup> nevoja e shprehur ose brenda një aktiviteti të projektit. Plani i veprimit përmban masat dhe aktivitetet që janë të nevojshme për zbatim brenda kornizës kohore të përcaktuar për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara dhe për të kontribuar në realizimin e vizionit të përcaktuar. Në kontekstin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, ekzistojnë dy qasje. Njëra është nëse kjo fushë përcaktohet si prioritet strategjik për përcaktim të masave dhe aktiviteteve përkatëse. Qasja e dytë është në kuadër të prioriteteve dhe qëllimeve të tjera, për përcaktim të masave dhe aktiviteteve përkatëse që do të kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm të fushave prioritare strategjike. Për shembull, nuk mund të bëhet fjalë për përmirësimin e furnizimit me ujë ose qasjen dhe disponueshmërinë e ujit, nëse nuk merren parasysh masat strukturore dhe jo-strukturore për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. Për shembull, masat për mbrojtje nga përmbytjet, ndërtimet sizmike, edukimi profesional, aplikimi i vlerësimit të rrezikut dhe kërcënimeve, ndërtimi i sistemit për paralajmërim të hershëm dhe alarm nga përmbytjet dhe masa të tjera. Një rast tjetër është mbrojtja e natyrës dhe e ekosistemeve, ku duhet të zbatohen masat për mbrojtjen nga rreziqet, zakonisht zgjidhje të bazuara në natyrë ose në bazë të ekosistemit zvogëlim të rreziqeve nga katastrofa. Gjithashtu, në kuadër të masave dhe aktiviteteve individuale, identifikohen bartësit e aktiviteteve dhe institucionet partnere të përgjithshme. Për çdo aktivitet përkufizohet tregues i suksesit/rezultati i pritshëm, afati kohor i zbatimit, si dhe vlerësim i shpenzimeve për zbatimin e tij dhe burimi i mundshëm i financimit. Vlerësimi i financimit mund të përcaktohet

54. \_ Për shembull, pas përmbytjes katastrofike të rrëmbyeshme nga gushti 2016 në Shkup, në strategjinë e qytetit të Shkupit "Shkupi rezistent - Strategjia për ndryshimet klimatike u instalua edhe Sektori për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa si një nga sektorët e rrezikuar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, krahas sektorit të ujit, i cili përcaktoi situatën në sektor dhe prioritetet, si dhe u miratuan një sërë masa dhe aktivitete në planin aksional.


ose sipas vlerave monetare të përcaktuara afërsisht ose përgjithësisht përcaktohet në tre nivele: *buxhet i vogël* ● / *buxhet mesatar* ● ● / *dhe buxhet i lartë* ● ● ●. Përcaktimi i burimeve financiare të nevojshme përcaktohet në baza vjetore, nëpërmjet buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, buxheteve të subjekteve në nivel kombëtar dhe subjekteve të tjera, nga burime të tjera, si dhe nga pjesëmarrja e donatorëve ose realizimi i projekteve ndërkombëtare. Burime të të dhënave dhe informacioneve të besueshme janë vlerësimet e kërcënimit në zonën e të gjitha NJVL-ve nga të gjitha llojet e rreziqeve dhe kërcënimeve, vlerësimet e kërcënimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planet për mbrojtjen dhe shpëtimin e NJVL-ve, hartat e rreziqeve dhe kërcënimeve, planet operacionale për llojet e ndryshme të rreziqeve natyrore të shkaktuara nga njeriu, si dhe plane strategjike të miratuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa.

- ▶ **Realizimi, komunikimi, monitorimi, vlerësimi dhe mësimet e nxjerra**  
- Ky është segmenti i fundit i procesit të miratimit të këtyre dokumenteve strategjike dhe nuk ndryshon shumë nga e njëjta fazë në planet strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa. Realizimi duhet të jetë multisektorial, në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen e subjekteve kompetente, duhet të jetë në kohë, efikas dhe efektiv, brenda kornizës kohore dhe buxhetore të përcaktuar. Zbatimi i masave dhe aktiviteteve synon të parandalojë krijimin e rrezikut duke reduktimin e rrezikut aktual, si dhe zbutjen e pasojave të dëmshme nga rreziqe të ardhshme dhe potencialisht të reja. Monitorimi dhe vlerësimi janë standarde, ndërsa mësimet e nxjerra duhet të trajtojnë aspektet e përfshira në zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, në mënyrë që të kontribuojnë në kodifikimin, ndarjen dhe transformimin e tyre në një nivel të ri cilësor, ku përfshirja e zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa do të jetë standardi dhe pjesë integrale e planifikimit dhe programimit strategjik të zhvillimit në nivel lokal. Gjithashtu një qasje e rekomanduar për të përmbledhur praktikën e mira dhe për t'i publikuar ato së bashku me mësimet e nxjerra në një dokument të veçantë.

### 3.4 Përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal

Zbatimi i ndërhyrjeve të projektit për zhvillim në nivel lokal nëse përfshin segmentin e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa mund të konsiderohet si një zbatim praktik i objektivave dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve dhe për kontribut në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rezistent të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve. Përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve në këtë segment kërkohet për të ndjekur ciklin standard të menaxhimit të projektit, nga faza fillestare e programimit dhe prioritizimit deri te monitorimi dhe vlerësimi, siç tregohet në diagramin më poshtë.

Figura 7 - Fazat e ciklit të menaxhimit me projektet



Ashtu si në rastin e mëparshëm, hapi i parë në përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është diagnostikimi i gjendjes ekzistuese. Kjo nënkupton identifikimin e aspekteve dhe situatës aktuale duke përfshirë zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në projektet e zhvillimit në nivel lokal. Kjo procedurë mund të kryhet vetëm nga njësi e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet personit/personave që mbulojnë këtë fushë dhe në koordinim e bashkëpunim me shërbime apo organe të tjera përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, si dhe në bashkëpunim me qendrat rajonale për menaxhim me kriza dhe njësitë rajonale për mbrojtje dhe shpëtim. Për këtë qëllim është planifikuar të përdoret një mjet i veçantë Lista teknike për kontrollin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal. Ky mjet synon të lehtësojë procesin e diagnostikimit duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna të cilat do të realizoheshin në një procedurë gjithëpërfshirëse dhe participative dhe do të përfshinin analizë të dokumenteve dhe të dhënave dhe diskutim të përbashkët të personave të përfshirë. Qëllimi që duhet të arrihet në këtë fazë është të fitohet një pasqyrë e gjendjes aktuale të përfshirjes së fushës, të identifikohen boshllëqet, dobësitë dhe sfidat, si dhe mundësia të nxirren rekomandime për aktivitetet vijuese.

## Lista teknike për kontroll të përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal

#	PYETJE	Po	Aktualisht	Jo	Koment/ shpjegim
1	A përfshihet zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa në programimin, priorizimin dhe përgatitjen e projekteve për zhvillim lokal?				
1.1	Nëse po, shpjegoni në cilën mënyrë, për shembull përmes shprehjeve të detyrimeve ligjore, aplikimi i dokumenteve apo konsultimi me institucionet kompetente dhe qytetarët.				
2.	Gjatë realizimit të intervenimeve projektuese për zhvillim lokal vallë përdoren analiza për ndikimet e katastrofave/ fatkeqësive elementare ose mjete siç janë analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve? <sup>55</sup>				
3.	A është konsultuar ndonjë nga dokumentet e mëposhtme në identifikimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë lokacionin: Vlerësimi i rrezikshmërisë në zonën e të gjitha NJVL-ve nga të gjitha llojet e rreziqeve dhe kërcënimeve, Vlerësimi i rrezikimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, planet operative për rreziqe të ndryshme apo harta ekzistuese e rreziqeve dhe kërcënimeve?				
4.	Gjatë identifikimit të aktiviteteve të projektit, duke përfshirë lokacionin e projektit, vallë konsultohet komuniteti lokal dhe vallë merren parasysh nevojat e tyre?				
5.	A përfshihet në dokumentacionin e projektit parimi i qëndrueshmërisë së gjërave apo ndërtimit ndaj rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu?				

<sup>55</sup> Analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve (ang. Cost-Benefit Analysis) është një analizë e shpenzimeve dhe përfitimeve dhe është një proces sistematik që përdoret për të analizuar cilat vendime të merren dhe cilat të anulohen për sa i përket pasojave nga katastrofat dhe ndikimit të zvogëlimit të rrezikut. Analisti i shpenzimeve dhe përfitimeve përmbledh shpërblimet e mundshme që priten nga një situatë ose veprim dhe më pas zbrit shpenzimet totale që lidhen me ndërmarrjen e atij veprimi. [https://www.aktion-deutschland-hilft.de/fileadmin/fm-dam/pdf/publikationen/ADH\\_Studie\\_EN\\_rev3.pdf](https://www.aktion-deutschland-hilft.de/fileadmin/fm-dam/pdf/publikationen/ADH_Studie_EN_rev3.pdf)

6.	Nëse bëhet fjalë për rindërtim ose rehabilitim të një objekti infrastrukturor, zbatohet rregulli Ndërtoni përsëri, më mirë? <sup>56</sup>				
7.	A merren parasysh rreziqet dhe kërcënimet gjatë monitorimit të zbatimit të ndërhyrjeve të projektit, duke përfshirë koordinimin me autoritetet kompetente?				
8.	A ka njohuri të mjaftueshme NJVL-të për ZRK dhe përfshirjen në ndërhyrjet e projekteve për zhvillimin lokal?				
8.1	Nëse nuk ka njohuri të mjaftueshme, çfarë duhet të prezantohet apo përmirësohet? (shpjego)				
9	A është i mjaftueshëm kuadri ekzistues për përfshirjen e zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal?				
9.1.	Nëse përgjigja është Jo, tregoni çfarë duhet të përmirësohet.				

<sup>56</sup> Ndërto përsëri, më mirë (ang. Build Back Better) është përdorim i fazave të rindërtimit, rehabilitimit dhe rikonstruktimit pas katastrofave për të rritur qëndrueshmërinë e kombeve dhe komuniteteve duke integruar masat për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa në rindërtimin e infrastrukturës fizike dhe sistemeve sociale dhe revitalizimin e mjeteve për jetesë, ekonomive dhe mjedis jetësor. Burimi: <https://www.undrr.org/terminology/build-back-better>



## Udhëzime për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në projektet për zhvillim lokal

- › **Faza 1:** Programimi - Kjo fazë është fillestare në ciklin e menaxhimit të projektit dhe lind nga planet dhe programet strategjike ose sektoriale, gjegjësisht planet e tyre të veprimit. I referohet shndërrimit të aktiviteteve në projekte specifike që kanë të bëjnë me përmirësimin e zhvillimit lokal. Ato mund të jenë të profileve të ndryshme, që rrjedhin nga masa strukturore ose jo strukturore. Zakonisht rezultojnë nga masat strukturore dhe i referohen ndërtimit, ose përmirësimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës ekzistuese lokale. Qasja duhet të jetë gjithëpërfshirëse me pjesëmarrjen e ekipit që punon në zbatimin e këtyre projekteve nga sektorët, por edhe të përfshijë persona nga segmenti i zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, si dhe nga autoritetet kompetente dhe ekspertë të jashtëm të cilët mund të kontribuojnë në realizimin e suksesshëm. Rrjedhimisht, ndërhyrjet e projektit janë prioritetizuar në bazë të vlerësimeve të rreziqeve dhe kërcënimeve dhe mjeteve të disponueshme. Prioritizimi mund të fokusohet në një rrezik specifik, elementë rreziku, një vendndodhje specifike makro ose mikro, një projekt të plotë ose një fazë specifike të realizimit të një projekti kompleks. Rezultati i kësaj faze është zhvillimi i një programi projekti që do të përmbajë bazat e kryqëzimit dhe do të përfshijë aspektet e listuara të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa. Kjo fazë, si dhe ajo në vijim, është e nevojshme të jenë gjithëpërfshirëse dhe participative me pjesëmarrjen e shërbimeve dhe organeve kompetente komunale, organeve kompetente, si dhe komunitetit dhe kastës profesionale.
- › **Faza 2:** Identifikimi i projektit - Në këtë fazë bëhet fjalë për identifikimin e saktë të projektit, fushës dhe përgjigjes për problemin, shtrirjes dhe natyrës së tij, mjetet e nevojshme financiare dhe burime të tjera, nevojat e komunitetit, dokumentacionin e nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të projektit. Në këtë fazë rekomandohet përfshirja e gjetjeve dhe rekomandimeve nga vlerësimet përkatëse të rreziqeve dhe kërcënimeve (veçanërisht elementët e rrezikut si ekspozimi dhe cenueshmëria e popullsisë dhe infrastruktura kritike), si dhe planet për rreziqet dhe hartat e rreziqeve dhe kërcënimeve. Në këtë proces, dimensionin e rrezikut nga katastrofa duhet të merret parasysh në strukturën e ndërhyrjes së projektit, duke siguruar parandalimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese, zbutjen e rreziqeve dhe kërcënimeve të ardhshme, si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjes.
- › **Faza 3:** Formulimi dhe përgatitja e projektit - Gjatë kësaj faze formulohet saktësisht projekti dhe fillojnë hapat praktik për realizimin fizik. Kjo bëhet duke përgatitur dokumentacionin e projektit dhe materialet e duhura, ose duke përcaktuar një detyrë projekti nëse bëhet fjalë për masa jostrukturore. Përveç kësaj, zbatohen aktivitete të tjera dhe përdoren mjete për të siguruar përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa, duke përfshirë pasojat e ndryshimeve klimatike, të cilat janë të pandashme nga zvogëlimi i rreziqeve në një kontekst

më të gjerë. Përpilohen studimet e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin, përgatiten matricat e rreziqeve, mund të përgatiten analiza të shpenzimeve dhe përfitimeve nga zgjidhjet e ofruara të projektit dhe mbahen takime konsultative me komunitetin dhe organizatat e prekura. Si më parë, në mënyrë praktike duhet të inkorporohen gjetjet dhe rekomandimet nga vlerësimet përkatëse të rreziqeve dhe kërcënimeve (veçanërisht elementët e rrezikut, përkatësisht ekspozimit dhe cenueshmërisë së popullsisë dhe infrastrukturës kritike), si dhe planet për rreziqet dhe hartat e rreziqeve dhe kërcënimeve, veçanërisht për lokacionet makro dhe mikro. Gjithmonë duhet të insistohet qasja të sigurojë rezistencë dhe qëndrueshmëri të intervenimit të projektit, si për vetë atë, ashtu edhe për mjedisin. Në këtë fazë përcaktohet edhe aspekti financiar i ndërhyrjes, pra buxheti, i cili mund të jetë tradicional, nga buxheti i komunës apo shtetit, nga donatorë, fonde zhvillimore dhe mekanizma ndërkufitar. Financimi duhet gjithashtu të mbështesë përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa duke siguruar burime të mjaftueshme për rezistencën dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjes, ndërsa vendimi mund të merret në bazë të vlerësimeve të rreziqeve dhe kërcënimeve dhe hartave të rreziqeve dhe kërcënimeve.

- › **Faza 4:** Zbatimi - Faza e realizimit të punëve dhe aktiviteteve nga ndërhyrja e projektit është segmenti në të cilin e gjithë ajo që u përcaktua më sipër realizohet në nivel praktik. Është veçanërisht e rëndësishme që përfshirja e planifikuar e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa të zbatohet në mënyrë përkatëse. Kjo mund të bëhet nëpërmjet respektimit të standardeve dhe procedurave, si dhe nëpërmjet mënyrës së ndërtimit apo zbatimit të detyrimeve dhe garantimit të sigurisë të lokacionit nga rreziqet natyrore dhe rreziqet të shkaktuara nga njeriu. Është gjithashtu e dëshirueshme që kjo fazë të jetë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse duke zhvilluar konsultime të herëpashershme dhe me informimin e autoriteteve kompetente, si dhe komunitetin dhe qytetarët.
- › **Faza 5:** Monitorimi dhe vlerësimi - Monitorimi i zbatimit të punimeve dhe aktiviteteve të ndërhyrjes së projektit është një procedurë e zakonshme dhe e rregullt për të siguruar zbatimin e suksesshëm të projektit, qëndrueshmërinë dhe rezistencën e tij. Monitorimi kryhet mbi bazën e një kuadri për monitorim me indikatorë, i cili duhet të përfshijë indikatorë të përshtatshëm në lidhje me zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, si për shembull rreziqe dhe kërcënime, popullatat e ekspozuara dhe e cenueshme (të dhëna të ndara), infrastrukturën e ekspozuar dhe të cenueshme (sektori, lloji). Gjithashtu edhe në këtë segment është shumë e rëndësishme të mbahet llogari për identifikimin dhe kodifikimin e mësimave të nxjerra që mund të zbatohen në projektet e ardhshme.

### 3.5 Vlerësimi i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

I fundit nga vazhda e aspekteve të përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal është aplikimi i mjetit për vlerësimin e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa. Kjo është e zbatueshme si në segmentin e planifikimit dhe programimit strategjik, ashtu edhe në zbatimin e ndërhyrjeve të projektit për të mbështetur zhvillimin lokal. Në fakt, ky pyetësor do të ishte një mjet për të kontrolluar rezultatet për mënyrën dhe madhësinë e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa. Edhe pse disa nga pyetjet dhe aspektet janë përpunuar tashmë në pjesë të veçanta, megjithatë si mjet kontribuon në analizën e suksesit të përfshirjes, praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra, si dhe në rekomandime dhe identifikimin e procedurave të mëtejshme për të siguruar integrim më të mirë të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në zhvillimit lokal. Kjo listë teknike paraqet vlerë të shtuar jo vetëm për vlerësimet e programeve në nivel lokal, por edhe një mjet praktik që mund të zbatohet në fazat e vlerësimit të planeve dhe programeve strategjike individuale, si dhe në ndërhyrjet e projekteve për zhvillimin lokal. Vetë çështjet mund të përfshihen edhe në procedurat e vlerësimit nga subjektet e jashtme ose në vlerësimet e brendshme të vazhdueshme për të analizuar dhe përmirësuar më pas politikën dhe praktikën e NJVL-së.

## Lista Teknike për vlerësimin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

#	FUSHA	PYETJE	RANGU			
			Po	Jo	Pjesërisht	Nuk aplikohet
1	Relevanca	Nëse intervenimi projektues përfshin aspektet e ZRK-së?				
		Cilat segmente dhe mjete për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa janë aplikuar dhe në cilat faza të intervenimit?				
		Nëse përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është në përputhje me qëllimet e zhvillimit lokal?				
		Sa e rëndësishme është përfshirja e zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa për komunitetet lokale, veçanërisht grupet e rrezikuara të qytetarëve?				
		Cili është niveli i komplementaritetit me fushat e tjera ndërsektoriale të përfshira në zhvillimin lokal?				
2	Efektiviteti dhe efikasiteti	A janë arritur qëllimet e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?				
		Cilat aspekte dhe faktorë janë kryesorë për arritjen e tyre?				
		A ka kontribuar përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në progresin dhe ndërtimin e politikave dhe kapaciteteve në fusha dhe sektorë të tjerë?				

2		Si është organizuar bashkëpunimi dhe koordinimi ndërministror dhe ndërsektorial dhe a janë organizuar në mënyrë efektive dhe efektive?				
		A ishin të mjaftueshme burimet e përdorura për realizimin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?				
		A përdoren burimet dhe mjetet e nevojshme në mënyrë transparente dhe në përputhje me politikën, kornizat normative dhe standardet?				
3	Ndikimi	Cili është ndikimi i përfshirjes në zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal? A është pozitiv apo negativ?				
		Në çfarë mase përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa ka ndikim në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të NJVL-ve, veçanërisht në planin afatmesëm dhe afatgjatë?				
		Çfarë ndryshime në programimin, planifikimin dhe ndërhyrjen e projektit në nivel lokal mund të shihen si rezultat i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?				

4	Qëndrueshmëria dhe mësimet e nxjerra	Cilat janë përfitimet për NJVL-të nga përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planifikimin strategjik dhe zhvillimor lokal dhe ndërhyrjet e projekteve?				
	Cilat janë përfitimet për palët e interesuara dhe komunitetet?					
	Cilët janë faktorët kryesorë që ndikuan në procesin dhe suksesin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal?					
	Deri në çfarë mase NJVL-ja është e gatshme të vazhdojë të përfshijë zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në të ardhmen dhe si?					
	Në çfarë mase do të përfshiheshin nevojat e identifikuar të komuniteteve, veçanërisht të grupeve të rrezikuara dhe si do të kontribuonin në realizimin e aktiviteteve?					
	Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të procesit lokal të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?					
	A mund të identifikohen praktikatat e mira nga përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?					
	Cilat janë mësimet e nxjerra dhe si mund të kontribuojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë në nivel lokal?					
	Cilat janë rekomandimet për të ardhmen?					

# 4. KONKLUSIONE

## 4. KONKLUSIONE

Përfshirja gjithëpërfshirëse e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është thelbësore për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rezistent në nivel lokal. Ky proces shtrihet nga miratimi i planeve strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa, përmes përfshirjes në programet dhe planet strategjike dhe sektoriale lokale, deri te integrimi përkatës në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal. Kjo qasje, ndonëse ende nuk është zhvilluar praktikisht në nivel global, kombëtar dhe lokal, ndërsa përfshirja nuk është realizuar plotësisht si në nivel strategjik ashtu edhe në atë sektorial, megjithatë theksohet dhe i jepet prioritet si në kuadrin global për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent, ashtu edhe brenda politikave kombëtare dhe kornizave normative.

Nevoja është identifikuar, e pranishme dhe për këtë arsye këto udhëzime janë baza për fillimin e një procesi sistematik të përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal. Një segment që mungon për momentin është përcaktimi i udhëzimeve për përfshirjen e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planet dhe programet sektoriale. Megjithatë, duke pasur parasysh nivelin aktual të përfshirjes ose më saktë mungesën e përfshirjes në nivel strategjik dhe projektor, sekuenca logjike do të ishte zbatimi i këtyre udhëzimeve, ndërtimi i kapaciteteve të duhura të administratës komunale në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe më pas identifikimi i qasjeve specifike sektoriale në një mënyrë të integruar dhe gjithëpërfshirëse.

Duke pasur parasysh gjithë këtë, njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë udhëzimet dhe mjetet e nevojshme për të iniciuar procesin e përfshirjes më të afërt të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në kornizat e tyre strategjike dhe zhvillimore dhe dokumentet programore dhe planifikuese. Hapi tjetër do të ishte shpërndarja e materialit, mbajtja e sesioneve për rritjen e ndërgjegjësimit për vendimmarrësit dhe politikëbërësit lokalë, së bashku me ekspertë nga administrata komunale, për të krijuar një masë kritike të burimeve profesionale për të filluar ciklin e përfshirjes. Rrjedhimisht, vijon miratimi i programeve dhe planeve strategjike, identifikimi i mundësive për përgatitjen e projekteve përkatëse dhe diagnostikimi i dokumenteve ekzistuese.



## BIBLIOGRAFIA

- › Popovski, V., Trenovski, B., Popovski, T. Municipal Crisis Management Response to COVID-19 Pandemics, Municipal Financing and Affected Services in the Republic of North Macedonia. UNDP. 2020.
- › Vasko Popovski. DRR Chapter for the 4th National Communication on Climate Change (Report). UNDP. 2021
- › Vasko Popovski. Development of the Guidance Notes on DRR Mainstreaming in the National Development Plans (Review Report). 2021.
- › Vasko Popovski. Studim për politika publike për menaxhim me kriza. IDSCS. 2021.
- › Martin Todevski, Ivana Qurkçieva. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe strategjive dhe menaxhimi me burimet njerëzore në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Qendra për Menaxhim me Ndryshime, Asociacioni për Konsulencë në Menaxhim MKA-2000, Qendra për Gazetari Hulumtuese QGH. 2018.
- › European Union Civil Protection. Peer Review – Report North Macedonia 2018. 2019.
- › UNDP. Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report for Former Yugoslav Republic of Macedonia. 2011.
- › UNESCAP. Mainstreaming Disaster Risk Reduction for Sustainable Development: A Guidebook for the Asia-Pacific. 2017.
- › UNISDR. Words into Action Guidelines. Implementation guide for local disaster risk reduction and resilience strategies. A companion for implementing the Sendai Framework Target E. 2018.
- › Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Programi për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021 - 2026. 2021.

## Ueb burime

- › **Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofa**  
<https://www.undrr.org/terminology/disaster-risk-reduction>  
<https://www.undrr.org/terminology/structural-and-non-structural-measures>  
<https://www.undrr.org/publication/disaster-risk-reduction-and-resilience-2030-agenda-sustainable-development>  
<https://www.undrr.org/terminology/build-back-better>
- › **Organizata Botërore Shëndetësore**  
<https://covid19.who.int/region/euro/country/mk>
- › **Marrëveshja e Parisit për klimë**  
[https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=XXVII-7-d&chapter=27&clang=en](https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XXVII-7-d&chapter=27&clang=en)
- › **Kombet e Bashkuara, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm**  
<https://sdgs.un.org/goals>  
<https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/2157sendaiframeworkfordrrren.pdf>  
<https://www.un.org/sustainabledevelopment/development-agenda/>
- › **Strategjia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa**  
[https://www.unisdr.org/files/7817\\_UNISDRTerminologyEnglish.pdf](https://www.unisdr.org/files/7817_UNISDRTerminologyEnglish.pdf)  
[https://www.unclearn.org/wp-content/uploads/library/unisdr\\_-\\_57399\\_drrresiliencepublicreview.pdf](https://www.unclearn.org/wp-content/uploads/library/unisdr_-_57399_drrresiliencepublicreview.pdf)
- › **Dokumentacioni i Kombeve të Bashkuara**  
<https://research.un.org/en/docs/dev>
- › **Komiteti Social dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin**  
[https://www.unescap.org/sites/default/files/publication\\_WEBdrr02\\_Mainstreaming.pdf](https://www.unescap.org/sites/default/files/publication_WEBdrr02_Mainstreaming.pdf)  
<https://www.unescap.org/sites/default/d8files/knowledge-products/Mainstreaming%20DRR%20in%20Development%20Planning%20and%20Finance%20by%20P.G%20Dhar%20Chakrabarti.pdf>
- › **Kuadri Sendai për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa**  
<https://sustainabledevelopment.un.org/frameworks/sendaiframework>
- › **Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim**  
<https://www.cadri.net/system/files/2021-06/FYR-Macedonia-DRR-Capacity-Assessment-Report-2011.pdf>
- › **Programi për zhvillimin e rajonit planor të Vardarit 2021 - 2026**  
<https://vardarregion.gov.mk/web/wp-content/uploads/2021/08/Programa-za-Razvoj-na-Vardarski-Planski-region-2021-2026.pdf>
- › **Programi për zhvillimin e rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026**  
<https://southwestregion.mk/web/wp-content/uploads/2021/07/FinalnaPrograma JUGOZAPADEN Planski Region 2021-2026.pdf>
- › **Programi për zhvillimin e rajonit planor Lindor 2021 - 2026**  
[https://eastregion.mk/wp-content/uploads/2022/02/Програма-за-развој-на-Источен-плански-регион-2021-2026\\_v2.2.pdf](https://eastregion.mk/wp-content/uploads/2022/02/Програма-за-развој-на-Источен-плански-регион-2021-2026_v2.2.pdf)

- › **Programi për zhvillimin e rajonit planor të Pollogut 2021 - 2026**  
[https://rdcpolog.mk/web/wp-content/uploads/2021/08/Програма-за-развој-на-Полошки-плански-регион-2021-2026-финална-нацрт-верзија\\_08.04.2021-1.pdf](https://rdcpolog.mk/web/wp-content/uploads/2021/08/Програма-за-развој-на-Полошки-плански-регион-2021-2026-финална-нацрт-верзија_08.04.2021-1.pdf)
- › **Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup, Planet strategjike për zvogëlimin e rreziqeve nga aksidentet dhe fatkeqësitë.**  
<https://idsocs.org.mk/mk/2022/02/01/стратешки-планови-за-намалување-на-ри/>
- › **Strategjia për ndryshime klimatike Shkupi rezistent**  
<https://skopje.gov.mk/media/4051/resilient-skopje-strategy-eng.pdf>
- › **Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike**  
<https://unfccc.int/sites/default/files/resource/mkdnc3.pdf>
- › **Ministria e Vetëqeverisjes Lokale**  
[https://mls.gov.mk/images/files/POLRD\\_2021-2026\\_MK\\_so%20korekcii\\_Final.pdf](https://mls.gov.mk/images/files/POLRD_2021-2026_MK_so%20korekcii_Final.pdf)  
[https://mls.gov.mk/images/files/Akciski%20plan%20\\_mk%20\(1\).pdf](https://mls.gov.mk/images/files/Akciski%20plan%20_mk%20(1).pdf)
- › **Metodologjia për zbatimin e aspekteve të ndryshimeve klimatike në planifikimin hapësinor me fokus në planin kombëtar hapësinor**  
<https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/40db321ed2ac26536dda473b3556686a416522bf669183d764ad723fd1070665.pdf>
- › **Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës**  
<https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2020-020-Mk.pdf>
- › **Aktion Deutschland Hilft**  
[https://www.aktion-deutschland-hilft.de/fileadmin/fm-dam/pdf/publikationen/ADH\\_Studie\\_EN\\_rev3.pdf](https://www.aktion-deutschland-hilft.de/fileadmin/fm-dam/pdf/publikationen/ADH_Studie_EN_rev3.pdf)

## 5. SHTOJCA

### Lista teknike për kontrollin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në dokumentet e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit në nivel lokal

#	PYETJE	Po	Aktualisht	Jo	Koment/ shpjegim
Pjesa e përgjithshme: Zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa në nivel loka					
1	A është miratuar Plan strategjik për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa apo plan tjetër strategjik në këtë fushë?				
2	A është miratuar ndonjë nga strategjitë e mëposhtme: ndryshime klimatike, rezistencë urbane?				
2.1	Nëse është miratuar ndonjë nga këto strategji, a përfshihet zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa?				
3	A është miratuar dhe përditësuar rregullisht Vlerësimi i rrezikshmërisë në zonën e të gjitha NJVL-ve, nga të gjitha llojet e rreziqeve dhe kërcënimeve				
4	A është miratuar dhe përditësuar rregullisht Vlerësimi për kërcënim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera?				
5	A është miratuar dhe përditësuar rregullisht Plani për Mbrojtje dhe Shpëtim i NJVL-së?				
6	A janë miratuar plane operacionale për rreziqe të ndryshme (përmytje, zjarre, etj.)?				
7	A janë hartuar dhe nëse zbatohen hartat për rreziqet dhe kërcënimet për zonën e NJVL-së?				
Pjesa: Planifikimi strategjik dhe zhvillimor në nivel lokal					
8	A është miratuar strategji apo plan strategjik për zhvillimin e NJVL-ve?				
9	A përfshihet ZRK-ja, në programet dhe planet sektoriale të miratuara?				
	Nëse përfshihet ZRK-ja, kjo është evidente, për shembull në prioritetet, synimet, aktivitetet, buxhetet, etj.				

10	A përdoren vlerësimet nga pikat 3 dhe 4 në përgatitjen e planeve dhe programeve strategjike të zhvillimit?				
11	A përdoren vlerësimet nga pikat 3 dhe 4 në përgatitjen e planeve dhe programeve sektoriale?				
12	A përdoren vlerësimet nga pikat 3 dhe 4 në formulimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore?				
13	A përdoren planet nga pikat 5 dhe 6 në përgatitjen e planeve dhe programeve strategjike të zhvillimit?				
14	A përdoren planet nga pikat 5 dhe 6 në përgatitjen e planeve dhe programeve sektoriale?				
15	A përdoren planet nga pikat 5 dhe 6 në formulimin dhe realizimin e projekteve zhvillimore?				
16	A është e mjaftueshme mbështetja për ZRK-në nga NJVL-ja dhe ZRK është një nga prioritetet në nivel lokal				
17	A ka njohuri të mjaftueshme në NJVL për ZRK-në dhe përfshirjen?				
17.1	Nëse nuk ka njohuri të mjaftueshme, çfarë duhet të prezantohet apo përmirësohet? (shpjego)				
18	A ka burime të mjaftueshme njerëzore me njohuritë e nevojshme për ZRK-në që mund të marrin pjesë në përfshirjen e ZRK-së në nivel lokal?				
18.1	A ka burime të mjaftueshme materiale dhe teknike dhe burime dhe mjete të TIK për ZRK që mund të kontribuojnë në përfshirjen?				
19	A ka marrë Kryetari i komunës, ndonjë vendim që tregon përfshirjen e ZRK-ve, në programet dhe planet e zhvillimit strategjik apo sektorial në nivel lokal?				
20	A ka marrë Këshilli ndonjë vendim që tregon përfshirjen e ZRK-ve në zhvillimin strategjik apo në programet dhe planet sektoriale në nivel lokal?				

21	A ka ndonjë politikë të miratuar në nivel lokal që adreson ZRK-në dhe mundësinë e përfshirjes lokale?				
22	A zbaton NJVL-ja projekte apo merr pjesë në zbatimin e projekteve që kanë komponentë për përfshirjen e ZRK-së, në nivel lokal?				
23	A ka mekanizma koordinimi efektiv dhe efikas në nivel lokal që mund të kontribuojnë në realizimin e përfshirjes së ZRK-së, në nivel lokal?				
24	Në çfarë mase marrin pjesë institucionet kompetente, qendrat rajonale për menaxhim me kriza dhe njësitë rajonale për mbrojtje dhe shpëtim në zbatimin e ZRK në nivel lokal? A është ajo procedurë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse?				
25	A janë të përfshirë përfaqësuesit e qytetarëve, veçanërisht grupet e rrezikuara në ZRK-të, në nivel lokal dhe në cilat faza dhe procedura?				
26	A është kuadri/struktura ekzistuese institucionale dhe organizative e mjaftueshme për ZRK efikase dhe efektive dhe përfshirjen e saj në nivel lokal?				

**Lista teknike për kontroll të përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal**

#	PYETJE	Po	Aktualisht	Jo	Koment/ shpjegim
1	A përfshihet zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa në programimin, priorizimin dhe përgatitjen e projekteve për zhvillim lokal?				
1.1	Nëse po, shpjegoni në cilën mënyrë, për shembull përmes shprehjeve të detyrimeve ligjore, aplikimi i dokumenteve apo konsultimi me institucionet kompetente dhe qytetarët.				
2.	Gjatë realizimit të intervenimeve projektuese për zhvillim lokal vallë përdoren analiza për ndikimet e katastrofave/ fatkeqësive elementare ose mjete siç janë analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve? <sup>57</sup>				
3.	A është konsultuar ndonjë nga dokumentet e mëposhtme në identifikimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë lokacionin: Vlerësimi i rrezikshmërisë në zonën e të gjitha NJVL-ve nga të gjitha llojet e rreziqeve dhe kërcënimeve, Vlerësimi i rrezikimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, planet operative për rreziqe të ndryshme apo harta ekzistuese e rreziqeve dhe kërcënimeve?				
4.	Gjatë identifikimit të aktiviteteve të projektit, duke përfshirë lokacionin e projektit, vallë konsultohet komuniteti lokal dhe vallë merren parasysh nevojat e tyre?				
5.	A përfshihet në dokumentacionin e projektit parimi i qëndrueshmërisë së gjërave apo ndërtimit ndaj rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu?				

<sup>57</sup> Analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve (ang. Cost-Benefit Analysis) është një analizë e shpenzimeve dhe përfitimeve dhe është një proces sistematik që përdoret për të analizuar cilat vendime të merren dhe cilat të anulohen për sa i përket pasojave nga katastrofat dhe ndikimit të zvogëlimit të rrezikut. Analisti i shpenzimeve dhe përfitimeve përmbledh shpërblimet e mundshme që priten nga një situatë ose veprim dhe më pas zbret shpenzimet totale që lidhen me ndërmarrjen e atij veprimi. [https://www.aktion-deutschland-hilft.de/fileadmin/fm-dam/pdf/publikationen/ADH\\_Studie\\_EN\\_rev3.pdf](https://www.aktion-deutschland-hilft.de/fileadmin/fm-dam/pdf/publikationen/ADH_Studie_EN_rev3.pdf).

6.	Nëse bëhet fjalë për rindërtim ose rehabilitim të një objekti infrastrukturor, zbatohet rregulli Ndërtoni përsëri, më mirë? <sup>58</sup>				
7.	A merren parasysh rreziqet dhe kërcënimet gjatë monitorimit të zbatimit të ndërhyrjeve të projektit, duke përfshirë koordinimin me autoritetet kompetente?				
8.	A ka njohuri të mjaftueshme NJVL-të për ZRK dhe përfshirjen në ndërhyrjet e projekteve për zhvillimin lokal?				
8.1	Nëse nuk ka njohuri të mjaftueshme, çfarë duhet të prezantohet apo përmirësohet? (shpjego)				
9	A është i mjaftueshëm kuadri ekzistues për përfshirjen e zvogëlimin të rreziqeve nga katastrofa në ndërhyrjet e projekteve për zhvillim lokal?				
9.1.	Nëse përgjigja është Jo, tregoni çfarë duhet të përmirësohet.				

<sup>58</sup> Ndërto përsëri, më mirë (ang. Build Back Better) është përdorim i fazave të rindërtimit, rehabilitimit dhe rikonstruktimit pas katastrofave për të rritur qëndrueshmërinë e kombeve dhe komuniteteve duke integruar masat për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa në rindërtimin e infrastrukturës fizike dhe sistemeve sociale dhe revitalizimin e mjeteve për jetesë, ekonomive dhe mjedis jetësor. Burimi: <https://www.undrr.org/terminology/build-back-better>



## Lista Teknike për vlerësimin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal

#	FUSHA	PYETJE	RANGU			
			Po	Jo	Pjesërisht	Nuk aplikohet
1	Relevanca	Nëse intervenimi projektues përfshin aspektet e ZRK-së?				
		Cilat segmente dhe mjete për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa janë aplikuar dhe në cilat faza të intervenimit?				
		Nëse përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa është në përputhje me qëllimet e zhvillimit lokal?				
		Sa e rëndësishme është përfshirja e zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofa për komunitetet lokale, veçanërisht grupet e rrezikuara të qytetarëve?				
		Cili është niveli i komplementaritetit me fushat e tjera ndërsektoriale të përfshira në zhvillimin lokal?				
2	Efektiviteti dhe efikasiteti	A janë arritur qëllimet e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?				
		Cilat aspekte dhe faktorë janë kryesorë për arritjen e tyre?				
		A ka kontribuar përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në progresin dhe ndërtimin e politikave dhe kapaciteteve në fusha dhe sektorë të tjerë?				

2		Si është organizuar bashkëpunimi dhe koordinimi ndërministror dhe ndërsektorial dhe a janë organizuar në mënyrë efektive dhe efektive?				
		A ishin të mjaftueshme burimet e përdorura për realizimin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?				
		A përdoren burimet dhe mjetet e nevojshme në mënyrë transparente dhe në përputhje me politikën, kornizat normative dhe standardet?				
3	Ndikimi	Cili është ndikimi i përfshirjes në zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal? A është pozitiv apo negativ?				
		Në çfarë mase përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa ka ndikim në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të NJVL-ve, veçanërisht në planin afatmesëm dhe afatgjatë?				
		Çfarë ndryshime në programimin, planifikimin dhe ndërhyrjen e projektit në nivel lokal mund të shihen si rezultat i përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?				

4.	Qëndrueshmëria dhe mësimet e nxjerra	Cilat janë përfitimet për NJVL-të nga përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në planifikimin strategjik dhe zhvillimor lokal dhe ndërhyrjet e projekteve?				
	Cilat janë përfitimet për palët e interesuara dhe komunitetet?					
	Cilët janë faktorët kryesorë që ndikuan në procesin dhe suksesin e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa në nivel lokal?					
	Deri në çfarë mase NJVL-ja është e gatshme të vazhdojë të përfshijë zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofa në të ardhmen dhe si?					
	Në çfarë mase do të përfshiheshin nevojat e identifikuar të komuniteteve, veçanërisht të grupeve të rrezikuara dhe si do të kontribuonin në realizimin e aktiviteteve?					
	Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të procesit lokal të zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?					
	A mund të identifikohen praktikatat e mira nga përfshirja e zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofa?					
	Cilat janë mësimet e nxjerra dhe si mund të kontribuojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë në nivel lokal?					
	Cilat janë rekomandimet për të ardhmen?					

# Informacione rreth projektit

Projekti “Përmirësimi i kapacitetit për menaxhim me kriza të komunave në Maqedoninë e Veriut” synon të forcojë menaxhimin strategjik me kriza në tetë komuna të zgjedhura, dhe të tregojë procesin e zhvillimit të planeve strategjike lokale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësi dhe katastrofa. Përmes projektit do të analizohet struktura ligjore dhe institucionale e sistemit për menaxhim me kriza, rolin e komunave që parashikon, dhe do të identifikohen boshllëqet dhe sfidat sistematike. Projekti financohet nga Mbretëria e Bashkuar, përmes Ambasadës Britanike në Shkup

Për më shumë informacion në lidhje me projektin, kontaktoni:

Misha Popoviq, Hulumtues i lartë | [misha@idscs.org.mk](mailto:misha@idscs.org.mk)

Marko Pankovski, hulumtues | [pankovski@idscs.org.mk](mailto:pankovski@idscs.org.mk)

Sara Janeska, hulumtuese e re | [sara@idscs.org.mk](mailto:sara@idscs.org.mk)

# Informacione rreth IDSCS-ë

Idscs është tink tenk organizatë, që hulumton Zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e së Drejtës dhe integrimet evropiane të maqedonisë. Idscs ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare Në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën politike Participative. Përmes forcimit të vlerat liberaliste, Idscs kontribuon në bashkëjetesën ndërmjet Diversiteteve.

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2, 1000 Shkup

Tel. nr./ faks: +389 2 3094 760

Posta elektronike: [contact@idscs.org.mk](mailto:contact@idscs.org.mk)

## Informacione për autorin

mr. Vasko Popovski është konsulent dhe praktikues i pavarur me përvojë shumë vjeçare në fushat e menaxhimit me rreziqet nga katastrofat, menaxhimi me kriza, inovacione me rezistencë. Ekspertiza e tij në fushat profesionale të veprimtarisë shtrihet në vendet e rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore dhe Juglindore. Ka kryer fakultetin juridik, studime pasuniversitare në shkencat politike dhe është kandidat për doktoraturë në shkencat e sigurisë. Gjatë vitit 2018/2019, si bashkëpunëtor i Fulbright dhe shkencëtar i ftuar, ishte pjesë e ekipit të Qendrës për Studimin e Katastrofave në Universitetin e Delaware, SHBA, ku realizoi pjesë të kërkimit të tij shkencor mbi temën e rezistencës dhe modelin e një shoqëri rezistente dhe mori pjesë në realizimin e kurrikulës mësimore

